



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 24 regjistër (JR)
Datë 16.05.2019

Nr. 14 i vendimit
Datë 09.07.2020

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Ardian Hajdari	Anëtar
Ina Rama	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 09.07.2020, ora 09:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Branko Hrvatin, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket ankimit:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Petrit Çeno, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 111, datë 27.02.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZË LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet C, pika 2, F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (në vijim "ligji nr. 84/2016"), shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, nëpërmjet të cilave kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 111, datë 27.02.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 111, datë 27.02.2019, ka vendosur *shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Petrit Çeno, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Durrës.*
2. Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), në bazë të neneve 31-33 të ligjit nr. 84/2016, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), në bazë të neneve 34-39 të ligjit nr. 84/2016 dhe nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “IKLD”), në bazë të neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të këtij ligji vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Petrit Çeno vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke mos vendosur mbi kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të vlerësimit të aftësive profesionale.
3. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, arriti në përfundimin se:
 - i. Për pasurinë apartament me sipërfaqe 98 m² dhe garazh me sipërfaqe 22 m², ndodhur në rr. “{***}”, subjekti i rivlerësimit: *i) nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit dhe garazhit; ii) ka fshehur vlerën e blerjes së këtij apartamenti dhe garazhit ndodhur në rr. “{***}” në deklaratën e interesave para fillimit të detyrës, të vitit 2003; iii) ka kryer deklaram të rremë në lidhje me të ardhurat që kanë shërbyer si burim për blerjen e këtij apartamenti dhe garazhit në Tiranë; iv) ka kryer deklaram të rremë në lidhje me apartamentin e shitur sipas kontratës nr. {***}, datë 21.07.2003, pasi objekt i kësaj kontrate shitjeje nuk është vetëm banesa e përfutur nga privatizimi, por edhe shtesa anësore me sipërfaqe 30 m², në pallatin nr. {***}, rr. “{***}”, Durrës; v) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e këtij apartamenti dhe garazhi.*
 - ii. Për pasurinë apartament me sipërfaqe 79 m², ndodhur në fshatin {***}, Komuna {***}, Kavajë, subjekti i rivlerësimit: *i) nuk shpjegoi bindshëm se përse çmimi i blerjes së këtij apartamenti është nën koston mesatare të ndërimit të banesave sipas udhëzimit të vitit 2003, duke pasur parasysh këtu edhe faktin se i njëjti apartament është shitur në vitin 2007 për një vlerë prej 38000 eurosh; ii) ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues nga burime të ligjshme për vitin 2003, në shumën -3428871 lekë, për të blerë këtë apartament; iii) ka bërë deklaram të rremë në lidhje me burimin e krijimit, për shkak se ka deklarime të ndryshme në periudha të ndryshme; iv) ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me këtë apartament.*
 - iii. Për pasurinë apartament me sipërfaqe 144 m², ndodhur në rrugën “{***}”, pallati “{***}”, Tiranë, në pronësi të bashkëshortes M. Ç., subjekti i rivlerësimit: *i) ka fshehur vlerën e pasurisë (apartament + garazh), të porositur me kontratën e sipërmarrjes me shoqërinë “{***}” ShPK, në deklaratën e pasurisë “vetting” të vitit 2017, ashtu edhe në deklaratat ndër vite pranë ILDKPKI-së; ii) ka fshehur vlerën reale të detyrimit të mbetur shoqërisë. Detyrimi i mbetur, referuar pagesave të deklaruara nga subjekti, rezulton të jetë në vlerën 27000 euro, ndërsa*

sipas deklarimeve ndër vite dhe deklarimit nga ana e shoqërisë, rezulton të jetë në vlerën 19.000 euro. Ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor nga ana e subjektit, në lidhje me pagesat e kryera; iii) ka kryer deklaram të rremë në lidhje me likuidimet ndaj shoqërisë “{***}” ShPK, për blerjen e apartamentit dhe garazhit, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur nga vetë shoqëria “{***}” ShPK, pagesa e parë me këtë shoqëri është bërë në vitin 2008, në shumën 3.700.000 lekë, ndërsa është deklaruar nga subjekti si pagesë e bërë në vitin 2009; iv) ka mungesë burimesh të ligjshme financiare në vitin 2008, për pagesën e shumës 3.700.000 lekë ose rreth 30.000 euro.

- iv. Për pasurinë tokë ullishte, me sipërfaqe 3000 m² dhe sipërfaqe 2775 m² ndodhur në {***}, Durrës, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit nuk provoi me anë të shpjegimeve apo dokumenteve mospërputhjet që ekzistonin midis deklarimit të tij dhe dokumentacionit të administruar në dosje, për mënyrën e fitimit të pronësisë së këtij asemi.
- v. Për pasurinë apartament me sipërfaqe 91,51 m², ndodhur në {***}, Kavajë, subjekti i rivlerësimit: i) ka fshehur dhe ka kryer deklaram të rremë në deklaratat e interesave privatë të viteve 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, në lidhje me apartament dhe vendparkim, në {***}, Kavajë; ii) ka fshehur në deklaratën e interesave privatë të vitit 2012, blerjen dhe kalimin e pronësisë së truallit të pronës në {***}, Kavajë; iii) nuk justifikon me dokumentacion ligjor se kur janë paguar ekzaktesisht këstet e këtij apartamenti; iv) ka fshehur në deklaratën periodike të vitit 2012, kontratën “Shitje për kalimin e së drejtës së pronësisë së truallit”, me shitës ALUIZNI dhe blerës M. Ç. për kalimin e truallit dhe ndërtimit në pronësi të znj. M. Ç., ku ka paguar vlerën prej 158412 lekësh të parcelës ndërtimore, vlerë kjo e padeklaruar; v) shpjegoi bindshëm mospërputhjet që ekzistonin mbi sipërfaqen e ndërtimit në aktmarrëveshjen, datë 06.06.2007, të porosisë dhe kontratës së shitjes në vitin 2014.
- vi. Për kredinë në vlerën prej 80000 eurosh, marrë nga Banka “Societe Generale Albania”: i) subjekti i rivlerësimit së bashku me bashkëshorten dhe djalin E. Ç kanë kryer deklaram të rremë ndaj bankës “Societe Generale Albania”, në lidhje me destinacionin e përdorimit të kredisë; ii) subjekti i rivlerësimit së bashku me bashkëshorten dhe djalin E. Ç. kanë mungesë dokumentacioni ligjor justifikues për të vërtetuar likuidimin e kësteve të kredisë nga shoqëria “{***}” ShPK, si përfituese indirekte e kredisë; iii) subjekti ka kryer deklaram të rremë në deklaratën e vitit 2012 për kredinë e marrë pranë “Societe Generale Albania” për strehim, pasi është fshehur apartamenti që do përfitohej, po ashtu edhe revokimi i kontratës për apartamentin, si dhe kalimi i kredisë në favor të shoqërisë “{***}” ShPK; iv) subjekti ka fshehur dhe kryer deklaram të rremë në deklaratën e vitit 2013 për shlyerjet e kredisë pranë “Societe Generale Albania”, pasi nga dokumentet rezulton se kredia ka kaluar që në vitin 2012 në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, por nuk është shlyer; v) subjekti i rivlerësimit ka fshehur në deklaratën “vetting” të vitit 2017, faktin që është akoma bashkëkredimarrës në këtë kredi.
- vii. Në lidhje me deklarimin e personit të lidhur, djalit të subjektit të rivlerësimit, E. Ç., subjekti i rivlerësimit: i) ka kryer deklaram të rremë në lidhje me personin e lidhur, E. Ç., në deklaratat ndër vite pranë ILDKPKI-së, në lidhje me pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërisë “{***}” ShPK; ka deklaruar blerjen e 50% të kapitalit në vitin 2011, në fakt blerja është bërë në vitin 2010. Në vitin 2012, ka shitur 5% të kuotave, ndërsa në vitin 2015 ka shitur edhe 12% të tyre; ii) ka fshehur në deklaratën “vetting” të vitit 2017, aksionet e personit të lidhur, z. E. Ç., në

*shoqëritë “{***}” ShPK; “{***}” ShPK; “{***}” ShPK; “{***}” ShPK; “{***}” ShPK; iii) ka fshehur në deklaratimet vjetore aksionet në shoqëritë e lartpërmendura.*

- viii. Për pasurinë automjet, tip “Renault Megane”, blerë në vlerën 18500 euro, *subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklaratim në lidhje me vlerën dhe mënyrën e pagesës së automjetit.*

Për vlerësimin tërësor, në lidhje me kriterin e pasurisë, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit:

- i. nuk arriti të provojë bindshëm fshehjet dhe deklaratimet e rreme të kryera në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë pranë ILDKPKI-së;*
- ii. nuk arriti të justifikojë me dokumentacion ligjor provues pasuritë e mosdeklaruara ndër vite;*
- iii. nuk arriti të provojë ligjshmërinë e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e pasurive;*
- iv. nuk arriti një nivel të besueshëm në lidhje me vlerësimin e pasurisë.*

Në lidhje me vlerësimin tërësor të procedurës së rivlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit, me anë të veprimeve dhe mosveprimeve të tij, ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

4. Në përfundim të procesit të rivlerësimit vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioni arriti në përfundimin që subjektit të rivlerësimit Petrit Çeno, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

II. Shkaqet e ankimit

Kundër vendimit nr. 111, datë 27.02.2019, të Komisionit është ushtruar ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”) nga subjekti i rivlerësimit Petrit Çeno, i cili kërkon ndryshimin e këtij vendimi dhe konfirmimin në detyrë.

II/1. Shkaqet procedurale të ankimit

5. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se Komisioni nuk u ka kthyer përgjigje 14 pyetjeve/kërkesave të ngritura prej tij pas marrjes së rezultateve të hetimit administrativ për vlerësimin e pasurisë.
6. Subjekti pretendon se gjatë hetimit administrativ në Komision nuk është njohur me materialet e administruara në dosje nga Komisioni dhe se arsyetimi i pretenduar nga kryesuesi i seancës gjyqësore se subjektit i është dhënë mundësia për të marrë dosjen e hetimit, por subjekti nuk e ka ushtruar këtë të drejtë, është totalisht i pabazuar në ligj, fakte apo dhe arsyetim të së drejtës.
7. Subjekti i rivlerësimit pretendon se disa nga pyetjet e Komisionit ishin të paqarta si në formulim, ashtu dhe në logjikë, apo të ndërprera për shkak të gabimit në shkrim.
8. Bazuar në pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore, duke përlllogaritur 30 ditë nga data 25.02.2019, ky afat është tejkaluar dhe shkelur nga ana e Komisionit, pasi afati i fundit për nxjerrjen e vendimit të arsyetuar ka qenë data 26.03.2019.

9. Subjekti i rivlerësimit pretendon se drejtuesi i trupit gjykues të Komisionit gjatë seancës dëgjimore është shprehur vazhdimisht se provat nuk janë marrë ende në administrim, ndërkohë që po gjatë seancës është shprehur se hetimi për subjektin e rivlerësimit ishte mbyllur, atëherë bazuar në cilat prova Komisioni vendosi mbylljen e hetimit.
10. Subjekti në ankim pretendon se në përfundim të seancës dëgjimore përfaqësuesit ligjorë nuk kanë kërkuar konfirmimin në detyrë, siç përcaktohet në pikën 20 të vendimit të Komisionit.
11. Subjekti pretendon në ankim se Komisioni në vendim është shprehur për shoqërinë “{***}” ShPK dhe shoqërinë “{***}” ShPK, të cilat si gjatë hetimit administrativ, ashtu dhe në seancë dëgjimore nuk i ka përmendur, duke mos i dhënë kështu mundësinë subjektit për t’u mbrojtur, duke mos respektuar procedurën për një proces të rregullt ligjor.
12. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni në bazë të ligjit nr. 84/2016, neni 61, pika 1 nuk është shprehur nëse pasuria e subjektit tejkalon dyfishin e pasurisë së justifikueshme nga ana e tij dhe e familjarëve për të marrë masën administrative të shkarkimit nga detyra.
13. Subjekti i rivlerësimit në ankim kërkon zhvillimin e gjykimit në seancë dëgjimore dhe jo në dhomë këshillimi sepse prej tij janë kërkuar prova dhe janë bërë kërkesa për Komisionin, të cilat janë jetike në vlerësimin e pasurisë së subjektit, të cilat nuk janë marrë në konsideratë nga ana e Komisionit.

II/2. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë

14. *Për pasurinë apartament me sipërfaqe 98 m² dhe garazh me sipërfaqe 22 m², ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, subjekti ka parashtruar këto shkaqe ankimi:*
 - i. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në përgjigje të pyetjeve të Komisionit, më datë 18.01.2019, ka dërguar dy mandatpagesa të disponuara prej tij, të lëshuara nga shoqëria e ndërtimit “{***}” ShPK dhe pjesa e mbetur e pagesës është bërë pas nënshkrimit të kontratës siç është specifikuar në kontratë. Pas shitjes së apartamentit në Durrës, është shlyer pagesa e mbetur për këtë pasuri. Subjekti ka kërkuar verifikimin e pagesave të bëra ndaj shoqërisë së ndërtimit “{***}” ShPK.
 - ii. Subjekti pretendon se sa i përket deklarimit periodik të vitit 2003, të ardhurat nga shitja e apartamentit në Durrës cilësohen si e ardhur e familjes. Komisioni duhet të rivendoste të gjitha transaksionet e kryera në realitetin e kohës në të cilin janë kryer këto transaksione, pasi dhe pse në kontratë mund të cilësohej se shuma ishte shlyer paraprakisht, në një marrëveshje besimi (*gentleman’s agreement*) palët binin dakord që kjo shumë mund të shlyhej dhe në një afat tjetër kohor.
 - iii. Subjekti pretendon se mospërputhja e vlerës së garazhit në kontratën që ai disponon me atë që është depozituar pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, është një gabim material dhe kërkon marrjen e informacionit nga avokati pranë të cilit është hartuar dhe noterit pranë të cilit është nënshkruar e regjistruar kontrata e shitjes së garazhit 22 m² me shoqërinë “{***}” ShPK, për të saktësuar mospërputhjet në vlerën e tij.
 - iv. Sa u përket të ardhurave për periudhën fiskale 1994-1996 të bashkëshortes nga personi fizik G. dhe shoqëria “{***}” ShPK, subjekti kundërshton arsyetimin e Komisionit, i cili e cilëson të paprovuar faktin që subjekti ka kërkuar informacion pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Durrës dhe Bashkisë Durrës dhe nuk vërteton mospërgjigjen nga ana e tyre. Sipas subjektit, nëse është e pamundur marrja e informacionit në institucionet përkatëse për shkak të mosbashkëpunimit nga

ana e tyre, është Komisioni që duhet të angazhohet për marrjen e informacionit, edhe pse nuk ka barrën e provës.

15. *Për pasurinë apartament 79 m², ndodhur në fshatin {***}, {***}, Kavajë, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar këto shkaqe ankimi:*

i. Lidhur me konstatimin e Komisionit se ka mospërputhje deklarimesh nga subjekti në periudha të ndryshme mbi burimin e krijimit të kësaj pasurie, subjekti pretendon se të ardhurat e familjes përfshijnë të gjitha të ardhurat që vijnë nga pagat, kursimet, shitjet apo marrëdhëniet tregtare që një apo disa pjesëtarë të familjes kanë pasur në kohë. Në këtë kuptim, shuma prej 5.600.000 lekësh që ka shërbyer si burim krijimi, është e ardhur e familjes e përfituar nga shitja e apartamentit në Durrës. Nëse analizohet kontrata e shitjes së apartamentit në Durrës, në të është cituar që pagesa është kryer jashtë zyrës noteriale dhe përpara nënshkrimit të kontratës.

ii. Subjekti pretendon se Komisioni nuk mund t’u referohet vlerave të tregut në qytetin e Kavajës sipas udhëzimit nr. 1, datë 08.05.2003, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave në tregun e lirë”, për përcaktimin e çmimit të këtij apartamenti që ndodhet në rrethina. Për të provuar faktin se çmimi i paguar nga subjekti për këtë apartament nuk është një çmim preferencial, nga subjekti janë depozituar dy kontrata të ngjashme të hartuara për afërsisht në të njëjtën periudhë kohe dhe kanë për afërsisht të njëjtën vlerë monetare/m².

16. *Për pasurinë apartament me sipërfaqe 144 m² dhe garazh me sipërfaqe 20 m², ndodhur në rrugën "{***}", pallati "{***}", Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar këto shkaqe ankimi:*

i. Subjekti i rivlerësimit pretendon se krijimi i vlerës prej 49.000 eurosh për pagesën e kështit të parë, të çmimit të apartamentit dhe garazhit ka ardhur: 8.000 euro nga pjesa e mbetur e vlerës prej 38.000 eurosh, të përfituara nga shitja e shtëpisë në {***}, Kavajë dhe nga kursimet e familjes të deklaruar ndër vite (viti 2005 – 1.755.000 lekë; viti 2006 – 1.100.000 lekë; viti 2007 – 1.280.000 lekë; viti 2008 – 1.300.000 lekë; viti 2009 – 1.900.000 lekë), në total 7.335.000 lekë, e konvertuar për afërsisht në 62.000 euro. Këto kursime janë shpenzuar pjesërisht për pagimin e shumës 49.000 dhe pjesa tjetër ka mbetur kursim i familjes.

ii. Subjekti i rivlerësimit pretendon se krijimi i vlerës prej 60.000 eurosh për pagesën e kështit të tretë të çmimit të apartamentit dhe garazhit, ka ardhur: nga tërheqja e shumës 22.000 GBP nga Banka Raiffeisen, e konvertuar në atë periudhë në vlerën 4.000.000 lekë; nga kursimet familjare të vitit 2014 në vlerën 2.500.000 lekë, të cilat në total janë 6.500.000 lekë. Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2013 është deklaruar shitje e apartamentit në vlerën 5.349.143 lekë, i cili bashkë me kursimet e vitit shkon për afërsisht 6.000.000 lekë. Kjo vlerë pjesërisht u konvertua në 33.000 GBP, të cilat në vitin 2014 u depozituan në Raiffeisen Bank. Kjo vlerë më pas u tërhoq; për shkollimin e vajzës së subjektit u përdorën 11.000 GBP dhe 22.000 GBP u konvertuan në lekë dhe u përdorën për pagesën e kështit të tretë së bashku me pjesën tjetër të kursimeve.

iii. Subjekti i rivlerësimit pretendon se për punimet e pakryera nga shoqëria e ndërtimit dhe të bëra nga ai vetë, në vlerën 6.083 euro, nuk ka nënshkruar amendim kontrate me shoqërinë. Kjo vlerë do t’i zbritet shumës së mbetur prej 19.650 eurosh në momentin kur shoqëria "{***}" ShPK do të regjistrojë banesën në ZVRPP. Subjekti pretendon se nuk ka detyrim ligjor për të depozituar faturat e punimeve pasi asnjëra prej tyre nuk tejkalon shumën e kërkuar me ligj për t’u deklaruar.

17. *Për pasurinë tokë ullishte, me sipërfaqe 3000 m² dhe me sipërfaqe 2775 m², ndodhur në {***}, Durrës, subjekti pretendon se Komisioni duhet të shqyrtonte me kujdes Aktet e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) dhe certifikatat e pronësisë të depozituara nga subjekti dhe ZVRPP, Durrës, për të kuptuar që bëhej fjalë për të njëjtën pronë me të njëjtat koordinata, dhe se mospërputhjet e konstatuara prej tij kanë ardhur si pasojë e ndryshimeve që ka pësuar AMTP nr. {***} pas fotografimit ajror të tokës. Gjatë seancës dëgjimore nga përfaqësuesja ligjore e subjektit, u kërkua vënia në dispozicion e AMTP-së nr. {***}, për të cilën nuk kishte dijeni.*
18. *Për pasurinë apartament me sipërfaqe 91,51 m², ndodhur në {***}, Kavajë, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar këto shkaqe ankimi:*
- Subjekti i rivlerësimit pretendon se vlera prej 30000 eurosh për pagesën e kështit të parë, ka ardhur nga pakësimi i gjendjes në *cash* për vitet 2008, 2009, 2010.*
 - Nga ana e subjektit është dorëzuar një vërtetim i lëshuar nga shoqëria për datat e pagesave për çdo kësht. Komisioni nuk mund të pretendojë që subjekti të ketë ruajtur fatura, mandatpagesa apo mandatar-këtime të taksave vendore dhe qendrore të një periudhe të hershme, kur ligji për arkivimin e dokumenteve zyrtare, vetë institucioneve u kërkon që pas 10 vitesh t'i asgjësojnë këto dokumente.*
19. *Për kredinë në vlerën prej 80000 eurosh, marrë nga banka “Societe Generale Albania”, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar këto shkaqe ankimi:*
- Subjekti pretendon se kredia personale e tërhequr nga E. Ç. pranë Bankës “Societe Generale Albania” ka kaluar në favor të shoqërisë “{***}” ShPK ose “{***}” ShPK dhe është përdorur për kapital qarkullues për shoqërinë, kryesisht në karburant, material ndërtimi, pajisje e vegla pune për të ngritur rishtazi kantierin e punës në karrierë.*
 - Subjekti pretendon se shuma e kredisë është paraqitur në pasqyrat financiare të vitit 2012 të shoqërisë, në zërin detyrime të tjera afatshkurtra, të pasivit të bilancit, më konkretisht në shumën prej 15.784.264 lekësh, nga të cilat 11.162.760 lekë ishin arkëtimit nga revokimi i kontratës së blerjes së një apartamenti me shoqërinë “{***}” ShPK, i kredisë personale të tërhequr nga ortaku E. Ç. pranë Bankës “Societe Generale Albania”. Ndërsa pjesa tjetër prej 4.621.504 lekësh, ishte kontribut i ortakut tjetër të shoqërisë në atë kohë, E. M.. Që nga momenti që kjo shumë ka kaluar në llogarinë e shoqërisë “{***}” ShPK, kështet e kredisë janë paguar nga shoqëria, kryesisht *cash*.*
20. *Në lidhje me deklarin e personit të lidhur, djalit të subjektit të rivlerësimit, E. Ç., subjekti i rivlerësimit ka parashtruar këto shkaqe ankimi:*
- Sa u përket ndryshimeve të pësuar në kuotat e kapitalit në shoqërinë “{***}” ShPK, që më pas u bë “{***}” ShPK, referuar ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar, si dhe formularëve të hartuar çdo vit nga ILDKPKI, në asnjë nga pikat nuk kërkohet deklarinin kaq të detajuar të ndryshimeve, të cilat bëheshin dhe zhbëheshin brenda vitit.*
 - Shoqëria “{***}” ShPK nuk ka kryer asnjëherë aktivitet, si dhe nuk ka realizuar të ardhura. Aktiviteti i kësaj shoqërie është pezulluar dhe është një shoqëri në likuidim.*
 - Shoqëria “{***}” ShPK figuron me status aktiv në QKB, por ka të paktën 2 vjet që ka kaluar pasiv në tatime, për arsye se që në fillim nuk është zhvilluar në asnjë moment aktivitet. Të ardhurat*

e gjeneruara nga kjo kompani që nga dita e parë e krijimit janë 0 lekë dhe është me status të pezulluar.

iv. Shoqëria “{***}” ShPK ka pasur aktivitet për vitin 2017, ka dalë me fitim në vlerën prej 108.228 lekë dhe nuk është marrë vendim asambleje për shpërndarje fitimi.

21. *Për pasurinë automjet, tip “Renault Megane”, blerë në vlerën 18.500 euro, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar këto shkaqe ankimi:*

i. Sipas subjektit, fatura tatimore e lëshuar nga koncensionari për blerjen e automjetit në vlerën 2.220.000 lekë, është vendosur në monedhën vendase në lekë. Vlera prej 18.500 eurosh, e deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, nëse do të konvertohej me kursin e kohës, do të ishte 2.220.000 lekë.

ii. Subjekti sqaron se mospërputhja nga koha e kontratës së shitjes, datë 15.08.2005, dhe faturës së lëshuar nga distributori “{***}” për këtë mjet me blerës “{***}” ShPK, më datë 26.10.2005, vjen pasi data e nënshkrimit të kontratës së shitjes korrespondon me porosinë e bërë në fabrikën e prodhimit, ndërsa fatura e lëshuar me dërgimin e automjetit në Portin e Durrësit.

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

22. Subjekti i rivlerësimit Petrit Çeno në ankimin e paraqitur ka kërkuar që shqyrtimi i çështjes në Kolegj të bëhet në seancë gjyqësore publike, me pretendimin se provat e kërkuara në Komision, të cilat nuk janë marrë në konsideratë nga Komisioni, janë jetike në vlerësimin e pasurisë së subjektit.

23. Trupi gjykues i Kolegjit çmon se nuk gjendet përpara kërkesave të nenit 51, pika 1¹ e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, që do të krijonte nevojën e debatit gjyqësor dhe do të legjitimonte shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Aktet shkresore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, u konsideruan të mjaftueshme nga trupi gjykues i Kolegjit për të vlerësuar pretendimet e subjektit të rivlerësimit.

24. Subjekti i rivlerësimit, pas marrjes së njoftimit për gjykimin e çështjes në dhomë këshillimi, më datë 09.07.2020, nuk paraqiti në Kolegj parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim. Në datën 06.07.2020, pranë Kolegjit u depozitua kërkesa e përfaqësueses ligjore të subjektit të rivlerësimit, G. Ç., me anë të së cilës u kërkuar:

i. Shtyrje e seancës së datës 09.07.2020, për arsye se nga ana e subjektit të rivlerësimit pritet marrja e disa provave të reja, që kanë lidhje me informacionin e kërkuar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, Bashkisë Durrës, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave mbi të dhënat për aktivitetin e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit gjatë periudhës 1991-1997 dhe nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës në lidhje me AMTP-në nr. {***}, për të cilën subjekti i rivlerësimit nuk ka asnjë informacion;

¹Neni 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 parashikon: “[...] Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji; b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankim është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendje faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike, duhet të përsëritë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë [...]”.

ii. Përjashtimi nga trupi gjykues në Kolegji i gjyqtarëve Ina Rama dhe Ardian Hajdari.

25. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se, bazuar në nenin 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, në këtë fazë të procesit palët mund të paraqesin vetëm parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, por jo fakte dhe prova të reja. Në aspektin procedural në zbatim të kësaj dispozite, paraqitja e parashtrimeve bëhet deri 5 ditë para seancës, ndërkohë që kërkesa e subjektit është depozituar më datë 06.07.2020, vetëm tri ditë para seancës gjyqësore në dhomë këshillimi. Trupi gjykues pasi analizoi kërkesën për shtyrjen e seancës në dhomë këshillimi, bazuar në nenin 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, e çmoi të panevojshme marrjen e informacionit pranë institucioneve, pasi edhe nëse këto prova që pretendon subjekti do të ishin marrë në konsideratë, përsëri nuk do të ndikonin në vendimmarrjen përfundimtare mbi çështjen objekt gjykimi dhe nuk përbëjnë shkak për shtyrje të seancës. Trupi gjykues i Kolegjit i shortuar, pasi mori në shqyrtim kërkesën për përjashtimin e gjyqtarëve Ina Rama dhe Ardian Hajdari, me vendimin nr. 24/4, datë 08.07.2020, vendosi mospranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit Petrit Çeno për përjashtimin e gjyqtarëve nga shqyrtimi i çështjes (JR) nr. 24, datë 16.05.2019.
26. Për arsyet e analizuara si më sipër, trupi gjykues vendosi të shqyrtojë çështjen në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, në bazë të nenit 49 të ligjit 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

III/1 Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit, lidhur me shkaqet e ankimit me natyrë procedurale

27. *Lidhur me shkakun procedural të ngritur në ankim nga subjekti i rivlerësimit, se Komisioni nuk u ka kthyer përgjigje 14 pyetje/kërkesave paraprake të ngritura pas marrjes së rezultateve të hetimit administrativ për vlerësimin e pasurisë, trupi gjykuesi Kolegjit vlerëson se Komisioni si gjatë seancës dëgjimore, ashtu dhe në vendimin përfundimtar, ka argumentuar arsyet e refuzimit të këtyre kërkesave. Trupi gjykues gjithashtu vlerëson se Komisioni ka vepruar në respektim të neneve 45, 49, 50, 51 dhe 52 të ligjit nr. 84/2016, duke administruar dokumentacionin e nevojshëm gjatë hetimit administrativ, duke kaluar barrën e provës subjektit për të provuar të kundërtën, duke ftuar subjektin të njihet me dokumentacionin e dosjes, të parashtrrojë shpjegimet, provat dhe kërkesat e nevojshme, dhe ka dalë në konkluzionet përkatëse mbi bazën e dokumentacionit ligjor që disponon. Sa më sipër, pretendimi i subjektit është i pabazuar.*
28. *Subjekti ka pretenduar në ankim se gjatë hetimit administrativ në Komision nuk është njohur me materialet e administruara në dosje nga Komisioni dhe se arsyetimi i pretenduar nga kryesuesi i seancës gjyqësore se subjektit i është dhënë mundësia për të marrë dosjen e hetimit, por subjekti nuk e ka ushtruar këtë të drejtë, është totalisht i pabazuar në ligj, fakte apo dhe arsyetim të së drejtës. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se me përfundimin e hetimit paraprak, Komisioni ka njoftuar subjektin konform nenit 47 të ligjit nr. 84/2016, për t’u njohur me rezultatet e hetimit, me materialet shkruesore të administruara në dosje përgjatë hetimit, si dhe për të paraqitur pretendimet e tij lidhur me rezultatet e hetimit. Ky fakt provohet nga provat e administruara në dosje, si vendimi nr. 2, datë 30.01.2019, i trupit gjykues të Komisionit “Për mbylljen e hetimit administrativ vetëm për kriterin e pasurisë, për subjektin e rivlerësimit z. Petrit Çeno”, në të cilin është vendosur ndër të tjera: [...]3. *Të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga KPK-ja në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe neneve 35-40 edhe 45-47 të Kodit të**

Procedurave Administrative [...], si dhe komunikimi elektronik me e-mail, më datë 30.01.2019, sipas së cilit subjekti i rivlerësimit është njoftuar: [...].5. Ju keni të drejtë të njiheni me materialet e dosjes nga momenti i marrjes së këtij njoftimi 6. Ju keni të drejtë të paraqisni prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit, apo të bëni kërkesa, jo më vonë se 10 ditë nga data e marrjes së këtij njoftimi.

Nga njoftimi i Komisionit i përcjellë me e-mail, datë 30.01.2019, trupi gjykues vlerëson se subjektit të rivlerësimit i është dhënë mundësia për t'u njohur me dokumentacionin e dosjes që nga momenti i marrjes së njoftimit, pa pasur nevojë të paraqesë paraprakisht një kërkesë. Afati 10-ditor i përcaktuar në njoftim, përfshin dhe momentin procedural për njohjen e dokumentacionit të dosjes dhe më pas paraqitjen e provave/shpjegimeve apo parashtrimin e kërkesave. Subjekti i rivlerësimit ka dërguar përgjigjet dhe pretendimet ndaj rezultateve të hetimit administrativ më datë 11.02.2019, në përfundim të afatit prej 10 ditësh, pa u paraqitur paraprakisht pranë Komisionit për t'u njohur me dosjen. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se Komisioni ka vepruar konform ligjit nr. 84/2016, në respektim të parimit të transparencës, duke i garantuar subjektit të gjitha mundësitë për ushtrimin e së drejtës për t'u njohur me dokumentet e dosjes së procedurës së rivlerësimit.

29. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se disa nga pyetjet e Komisionit ishin të paqarta si në formulim, ashtu dhe në logjikë, apo të ndërprera për shkak të gabimit në shkrim. Nga shqyrtimi i përgjigjeve ndaj pyetësorëve të Komisionit, dërguar nga subjekti më datë 17.02.2018 dhe më datë 18.01.2019, nuk rezulton të jetë ngritur pretendimi se këto pyetje janë të paqarta apo me gabime në shkrim. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se pyetja e Komisionit është e paqartë apo e paplotë, është ngritur nga subjekti i rivlerësimit në dy raste², në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ të Komisionit në lidhje me mospërputhjen e vendbanimit të personit të lidhur/bashkëshortes si përfituese e tokës bujqësore, si dhe me mospërputhjen në deklaram të vendndodhjes së sipërfaqes së tokës të përfitur me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991, "Për tokën", i ndryshuar. Për sa pretendon subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se këto dy pyetje të Komisionit, nisur nga formulimi, kanë qenë lehtësisht të kuptueshme dhe nuk rezulton të kenë penguar subjektin të japë shpjegimet e tij.*
30. *Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit në ankim se bazuar në pikën 7 të nenit 55 të ligjit 84/2016, vendimi me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore, duke përlllogaritur 30 ditë nga data 25.02.2019, ky afat është tejkaluar dhe shkelur nga ana e Komisionit, pasi afati i fundit ka qenë data 26.03.2019, trupi gjykues nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes konstaton se Komisioni ka shpallur vendimin e tij më datë 27.02.2019, ndërsa vendimi i arsyetuar me shkrim i është përcjellë subjektit me shkresë zyrtare³ më datë 19.04.2019. Në këto kushte, pretendimi i subjektit në lidhje me tejkalimin e afatit 30 ditë nga Komisioni në nxjerrjen e vendimit me shkrim, qëndron, por ky fakt nuk afekton vlefshmërinë e vendimit, i cili përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016.*
31. *Lidhur me pretendimin e subjektit se përderisa drejtuesi i trupit gjykues të Komisionit gjatë seancës dëgjimore është shprehur vazhdimisht se provat nuk janë marrë ende në administrim, ndërkohë që po gjatë seancës është shprehur se hetimi për subjektin e rivlerësimit ishte mbyllur,*

²Shih faqen 22 të "Relacion mbi rezultatet e hetimit kryesisht për vlerësimin e pasurisë të subjektit të rivlerësimit, z. Petrit Çeno" me përgjigjet e subjektit.

³Shkresa nr. {***} prot., datë 19.04.2019, "Njoftim i vendimit nr. 111, datë 27.02.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Petrit Çeno".

atëherë bazuar në cilat prova Komisioni vendosi mbylljen e hetimit, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se nga Komisioni gjatë hetimit administrativ është administruar i gjithë dokumentacioni i dërguar nga institucionet sipas përcaktimeve të neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, si dhe dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit, duke zbatuar të gjitha rregullat ligjore për zhvillimin e hetimit dhe administrimin e provave shkresore që kanë mbështetur mbylljen e këtij hetimi administrativ nga ana e tij.

32. *Subjekti në ankim pretendon se në përfundim të seancës dëgjimore, përfaqësuesit ligjorë nuk kanë kërkuar konfirmimin në detyrë siç përcaktohet në pikën 20 të vendimit të Komisionit. Në lidhje me këtë shkak ankimi, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pavarësisht çfarë kanë deklaruar përfaqësuesit ligjorë në përfundim të seancës dëgjimore, shprehja e këtij kërkimi i cili përkon me interesin e subjektit, nuk e bën vendimin e Komisionit të cenueshëm.*
33. *Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni në vendimin e tij është shprehur për shoqërinë “{***}” ShPK dhe shoqërinë “{***}” ShPK, të cilat si gjatë hetimit administrativ, ashtu dhe në seancë dëgjimore nuk i ka përmendur, duke mos i dhënë kështu mundësinë subjektit për t’u mbrojtur, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se nëse i referohemi relacionit mbi rezultatet e hetimit administrativ, në faqen 23 gjenden dy konstatime të Komisionit, konkretisht: [...]vii. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2009 emërimin e E. Ç. si ortak me 80% të kuotave të shoqërisë {***}” ShPK.*
*viii. Mosdeklarim nga E. Ç. si ortak i {***} ShPK në deklaratën e vitit 2012 të emërimit si ortak me 50 % të kuotave të kapitalit në shoqërinë {***} ShPK. Mosdeklarim në deklaratën e vitit 2013 të emërimit të E. Ç. si administrator i saj. Për këto konstatime të Komisionit, subjekti ka parashtruar shpjegimet e tij, dërguar me e-mail më datë 11.02.2019. Pra, subjekti është vënë në dijeni, madje ka dhënë edhe shpjegime për këto fakte. Për pasojë, pretendimi i subjektit është i pambështetur.*
34. *Sa i përket pretendimit të subjektit se Komisioni në bazë të ligjit nr. 84/2016, neni 61, pika 1 nuk është shprehur nëse pasuria e subjektit tejkalon dyfishin e pasurisë së justifikueshme nga ana e tij dhe familjarëve për të marrë masën administrative të shkarkimit nga detyra, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky pretendim është i pabazuar, pasi vendimi nr. 111, datë 27.02.2019, i Komisionit, nuk është mbështetur në nenin 61, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 por Komisioni ka zbatuar nenin 61, pika 3 dhe 5, të këtij ligji, të cilët në procesin e rivlerësimit të subjektit Petrit Çeno, interpretohen në deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nga vlerësimi tërësor për këtë kriter, është arritur në përfundimin se subjekti ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.*

III/2. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe shkaqet e ankimi

35. Subjekti i rivlerësimit Petrit Çeno, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
36. Subjekti i rivlerësimit Petrit Çeno është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, me numër indeksi {***} dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049”) dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave privatë.
37. ILDKPKI-ja, në përfundim të procedurës së plotë të kontrollit të pasurisë, ka përgatitur raportin përfundimtar të paraqitur në Komision dhe, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se për subjektin e rivlerësimit Petrit Çeno:
- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
 - *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
 - *ka kryer fshehje të pasurisë;*
 - *ka kryer deklarim të rremë;*
 - *nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
38. Nisur nga aktet shkresore që janë administruar në dosjen gjyqësore, si dhe shkaqet në ankim të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 30 e vijues të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit kryen kontrollin e vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit Petrit Çeno, në përputhje me kriteret që parashikojnë dispozitat e mësipërme.
39. ***Për pasurinë apartament me sipërfaqe 98 m² dhe garazh me sipërfaqe 22 m², ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë.***
40. Komisioni për këtë pasuri ka vendosur: i) *subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit dhe garazhit; ii) ka fshehur vlerën e blerjes së këtij apartamenti dhe garazhit ndodhur në rr. “{***}” në deklaratën e interesave para fillimit të detyrës, të vitit 2003; iii) ka kryer deklarim të rremë në lidhje me të ardhurat që kanë shërbyer si burim për blerjen e këtij apartamenti dhe garazhit në Tiranë; iv) ka kryer deklarim të rremë në lidhje me apartamentin e shitur sipas kontratës nr. {***}, datë 21.07.2003, pasi objekt i kësaj kontrate shitjeje nuk është vetëm banesa e përfituar nga privatizimi, por edhe shtesa anësore me sipërfaqe 30 m², në pallatin nr. {***}, rr. “{***}”, Durrës; v) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e këtij apartamenti dhe garazhi.*
41. Nga shqyrtimi i provave të administruara në dosjen gjyqësore, trupi gjykues vëren se në emër të subjektit të rivlerësimit Petrit Çeno dhe bashkëshortes së tij, M. Ç. (L1.), figuron i regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme⁴ (në vijim ZVRPP), Tiranë, apartamenti me sipërfaqe 98 m² dhe garazhi me sipërfaqe 22 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë.

⁴ZVRPP Tiranë, me shkresën nr. {***} prot., datë 21.06.2018, konfirmon:

1-pasuria nr. {***}, vol. {***}, faqe {***}, zona kadastrale {***}, lloji i pasurisë apartament me sipërfaqe 98 m², (pasuri aktuale);

2-pasuria nr. {***}, vol. {***}, faqe {***}, zona kadastrale {***}, lloji i pasurisë garazh me 22 m², (pasuri aktuale).

42. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në deklaratën e pasurisë të vitit 2003 nga subjekti i rivlerësimit Petrit Çeno: *Banesë 2+1, me sipërfaqe ndërtimi 98 m², rr. “{***}”, nr. {***}, Tiranë. Është blerë nga shitja që kam bërë të shtëpisë të privatizuar si banesë ish-shtetërore në qytetin e Durrësit.* Në deklaratën e pasurisë *vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit Petrit Çeno deklaroi se apartamenti është blerë nëpërmjet kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.04.2003, me palë shitëse Gjykata e Apelit Tiranë dhe shoqëria “{***}” ShPK dhe blerës Petrit Çeno dhe M. Ç., në vlerën 1.960.000 lekë, dhe garazhi është blerë nëpërmjet kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol, datë 16.04.2003, me palë të njëjta, në vlerën 460.000 lekë. Po në deklaratën e pasurisë *vetting* 2017, subjekti deklaroi se si burim krijimi të këtyre pasurive kanë qenë kursimet e të ardhurave familjare para vitit 1997, si dhe një pjesë e mbetur nga shitja e një banese në Durrës, e cila vërtetohet me kontratën e shitjes nr. {***} rep., {***} kol, datë 21.07.2003.
43. Referuar deklaratimeve sa më sipër, lidhur me burimin e krijimit të këtyre pasurive, rezultoi se subjekti ka mospërputhje në deklaratimet e tij, pasi në deklaratën e pasurisë të vitit 2003 deklaroi se si burim krijimi ka shërbyer *shitja e shtëpisë së privatizuar si banesë ish-shtetërore në qytetin e Durrësit*, ndërsa sipas deklaratës së pasurisë *vetting* 2017, nga kursimet e të ardhurave familjare para vitit 1997, si dhe pjesa e mbetur nga shitja e një banese në Durrës. Gjithashtu në deklaratën e interesave privatë të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar çmimin e apartamentit në vlerën 1.960.000 lekë dhe garazhit me sipërfaqe 22 m², në vlerën 460.000 lekë.
44. Më datë 18.01.2019, në përgjigjet e pyetësorit të Komisionit, mbi specifikimin sesa ka qenë kontributi në përqindje e vlerë, nga pjesa e kursimeve dhe nga shitja e shtëpisë në Durrës, që kanë shërbyer si burim krijimi për këto pasuri, subjekti është përgjigjur se në vitin 1997 janë paguar 588.000 lekë (mandatarkëtimi nr. 13, datë 30.01.1997), në vitin 1998 janë paguar 240.000 lekë (mandatarkëtimi nr. 14, datë 22.04.1998). Sipas subjektit, nga të ardhurat e familjes deri në vitin 1998 është paguar shuma prej 828.000 lekësh ose 34,3% e vlerës së apartamentit dhe garazhit dhe në vitin 2003 kur është shitur apartamenti në Durrës sipas kontratës së datës 21.07.2003, është shlyer pjesa e mbetur e detyrimit në shumën 1.592.000 lekë, 65,7% e vlerës.
45. Lidhur me shpjegimet e subjektit të rivlerësimit sa më sipër, Komisioni me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 09.01.2019, i drejtohet shoqërisë “{***}” ShPK për informacion dhe dokumentacion në lidhje me kontratat e nënshkuara, mandatarkëtimet dhe detyrimet financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur të tij, ndaj kësaj shoqërie. Kjo shoqëri me shkresën nr. *extra* prot., datë 08.02.2019, informon Komisionin se, në zbatim të ligjit për mbajtjen e dokumenteve, janë asgjësuar të gjitha dokumentet që kishin kaluar afatin 10 vjet [më saktësisht mandatpagesat], por nga regjistrat e shoqërisë të cilët janë pasqyruar dhe në pasqyrat financiare të çdo viti, figurojnë pagesat:
- *Datë 31.01.1997, në vlerën 4900 \$ x 120 lekë = 588000 lekë*
 - *Datë 22.04.1998, në vlerën 2000 \$ x 120 lekë = 240000 lekë*
 - *Datë 25.07.2003, në vlerën 1692000 lekë*

Nga deklaratimet e subjektit dhe informacioni i përcjellë me shkresën e shoqërisë “{***}” ShPK, trupi gjykues i Kolegjit konstaton mospërputhje në vlerën e kështit të tretë, në diferencën prej 100.000 lekësh, pasi subjekti e deklaroi në vlerën 1.592.000 lekë, ndërsa shoqëria në vlerën 1.692.000 lekë. Shoqëria “{***}” ShPK nuk depozitoi dokumentacion justifikues, si kopje të

regjistrave apo të pasqyrave financiare nga të cilat janë nxjerrë këto të dhëna për të konfirmuar datat dhe pagesat sipas përcaktimeve në shkresë.

46. Lidhur me burimin e krijimit të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, në Kolegj u krye analiza financiare mbështetur në dokumentacionin justifikues ligjor të administruar në dosjen gjyqësore për të provuar mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur me të për shlyerjen e dy kësteve, përkatësisht më 30.01.1997 dhe 22.04.1998, në vlerat respektive 588.000 lekë dhe 240.000 lekë, duke marrë në konsideratë të ardhurat e ligjshme dhe shpenzimet e kryera për periudhën shkurt 1983 deri më 22.04.1998.
47. Në analizën financiare të kryer në Kolegj u konsideruan të ardhurat nga pagat neto të subjektit të rivlerësimit për periudhën 01.02.1983 – 22.04.1998, sipas dokumentacionit justifikues ligjor të përcjellë nga institucionet respektive. Për këtë periudhë nuk janë konsideruar të ardhura nga burime të ligjshme për bashkëshorten e subjektit, pasi nga dokumentacioni ligjor i paraqitur nga subjekti dhe institucionet përkatëse, nuk provohet sa pretendohet nga subjekti i rivlerësimi lidhur me këto të ardhura. Nga analizimi i dokumentacionit të administruar, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se: *së pari*, në kopjen e librezës së punës dhe dokumentin “Akt-verifikimi i vjetërsisë në punë para vitit 1994”, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, nr. {***}, datë 07.07.2016, nuk përcaktohen me shifra pagat neto apo bruto të përfituara nga punësimi pranë Ndërmarrjes së Gomës Durrës për periudhën 04.07.1983 - 01.04.1989 dhe nga punësimi pranë Ndërmarrjes Frutore Durrës, për periudhën 01.04.1989 - 20.07.1993. *Së dyti*, edhe në vërtetimin nr. {***} prot., datë 07.02.2019, të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Durrës, pavarësisht se citohet që subjekti fizik M. Ç. (Ll.) ka derdhur kontribut sigurimi shoqëror për periudhën 21.11.1994 - 30.04.1996, nuk jepen të dhëna me shifra mbi të ardhurat e përfituara nga paga për këtë periudhë. *Së treti*, të ardhurat e pretenduara nga subjekti se janë përfituar nga bashkëshortja për periudhën 1994-1996 nga ushtrimi i veprimtarisë doganore/spedicionere në emrin tregtar {***} ShPK, nuk konfirmohen nga Drejtoria Rajonale të Tatimeve Durrës, e cila me shkresën nr. {***} prot., datë 27.12.2017, vërteton se shoqëria {***} ShPK, me kod fiskal {***}, nuk rezulton e regjistruar, por me këtë kod fiskal rezulton i regjistruar M. Ç. person fizik, për të cilin nuk figurojnë të dhëna të tjera. *Së katërti*, lidhur me të ardhurat e pretenduara si aksionere me 11,11% të kuotave në shoqërinë “{***}” ShPK, nga të dhënat sipas dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, rezulton se kjo shoqëri është themeluar me vendim gjykate nr. {***}, datë 31.10.1994, si dhe regjistruar në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Durrës më datë 24.03.1999, vërtetuar nga kjo drejtori me shkresën nr. {***} prot., datë 31.10.2016. Si rrjedhojë, të ardhurat si aksionere pranë kësaj shoqërie nuk mund të kenë shërbyer si burim për pagesën e këstit të parë dhe të dytë të apartamentit dhe garazhit, ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë. Nga analiza e mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit në lidhje me mosmarrjen në konsideratë të të ardhurave të pretenduara për bashkëshorten.
48. Në konsideratë sa më sipër, nga analiza financiare e kryer në Kolegj, rezultoi që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, për të shlyer këstin e parë në vlerën 339.162 lekë dhe këstin e dytë në vlerën 104.468 lekë, në total 443.630 lekë.
49. Sa i përket kundërshtimit të subjektit në ankim mbi arsyetimin e Komisionit lidhur me të ardhurat e bashkëshortes nga shoqëria {***} ShPK dhe shoqëria “{***}” ShPK për periudhën fiskale 1994-1996, duke cilësuar të paprovuar faktin që subjekti ka kërkuar informacion pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, Durrës dhe Bashkisë Durrës, si dhe të pavërtetuar mospërgjigjen nga ana e

tyre, trupi gjykues i Kolegjit vëren se Komisioni në lidhje me kërkesat drejtuar Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Durrës ka arsyetuar:[...]subjekti i vlerësimit nuk provoi se Drejtoria Rajonale e Tatimeve kishte marrë në dorëzim kërkesën për informacion në lidhje me shoqërinë {***}ShPK, ndërkohë që për shoqërinë “{***}” ShPK, institucioni shtetëror/Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës, ka kthyer përgjigje sipas kërkesës së subjektit të rivlerësimit [...]”.

Pasi shqyrtoi kërkesat⁵ e subjektit të rivlerësimit të administruara në dosjen gjyqësore nga Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit vëren se të gjitha këto kërkesa, përfshirë dhe ato në lidhje me shoqërinë {***}ShPK mbajnë numrin e protokollit të Drejtorisë Rajonale Tatimore, Durrës, por nga ana tjetër, trupi gjykues çmon të drejtë vlerësimin e Komisionit se subjekti nuk shpjegoi apo provoi bindshëm që ka qenë në kushtet e pamundësisë objektive për të disponuar dokumentacionin që, sipas pretendimeve të tij, ishte djegur gjatë trazirave të vitit 1997, si dhe nuk provoi se institucionet shtetërore nuk përgjigjen brenda afatit ligjor, sipas parashikimeve të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016⁶.

50. Lidhur me pretendimin e subjektit se nëse për individin është e pamundur marrja e informacionit në institucionet përkatëse për shkak të mosbashkëpunimit nga ana e tyre, është Komisioni që duhet të angazhohet për marrjen e informacionit edhe pse nuk ka barrën e provës, trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi dokumentacionin e dosjes gjyqësore, vëren se, nga informacioni i përcjellë nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës, me shkresat drejtuar subjektit të rivlerësimit, ILDKPKI-së dhe Komisionit gjatë hetimit administrativ, ka ofruar gjithë informacionin e nevojshëm mbi të ardhurat e bashkëshortes së subjektit, M. Ç. (Ll.), si person fizik, për aktivitetin privat agjenci doganore “{***}”, aktivitetin “Furrë buke” dhe tregti konfeksione, si dhe të ardhurat si aksionere në shoqërinë “{***}” ShPK, shoqërinë “{***}” ShPK dhe shoqërinë “{***}” ShPK.
51. Në analizë të dokumentit shkresor të trajtuar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se Komisioni nuk i ka refuzuar këto kërkesa si të pavlefshme, siç pretendon subjekti i rivlerësimit, por në vlerësimin e tij, provat shkresore të administruara nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës

⁵Konkretisht:

1. kërkesë për certifikim dokumentacioni, drejtuar Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Durrës (DRTD) nr. {***} prot., datë 14.10.2016 (për shoqërinë “{***}” ShPK);
2. kërkesë për certifikim dokumentacioni, drejtuar Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Durrës nr. {***} prot., datë 24.10.2016 (për personin fizik M. Ç. (Ll.), Agjenci doganore “{***}”);
3. kërkesë për pajisje me vërtetim mbi veprimtarinë e biznesit në vite, drejtuar DRTD, nr. {***} prot., datë 03.11.2016 (për personin fizik M. Ç. (Ll.), Agjenci doganore “{***}”);
4. kërkesë për plotësim të plotë dokumentacioni, drejtuar DRTD, nr. {***} prot., datë 09.11.2016 (për shoqërinë “{***}” ShPK);
5. kërkesë e përsëritur për pajisje me vërtetim mbi veprimtarinë e biznesit në vite, drejtuar DRTD, nr. {***} prot., datë 22.11.2016 (për personin fizik M. Ç. (Ll.), Agjenci doganore “{***}”);
6. kërkesë e përsëritur për plotësim të plotë dokumentacioni, drejtuar DRTD, nr. {***} prot., datë 22.11.2016 (për shoqërinë “{***}” ShPK);
7. kthim përgjigjeje, drejtuar DRTD, me nr. {***} prot., datë 07.12.2016 (për personin fizik M. Ç. (Ll.), Agjenci doganore “{***}”);
8. kërkesë, drejtuar Bashkisë Durrës, nr. {***} prot., datë 08.02.2019, “Kërkesë për vërtetim që subjekti person fizik privat M. P. Ç. (Ll.), ka zhvilluar aktivitet në Bashkinë Durrës, në periudhën 1994-1996.

⁶Neni 32, pika 2: “Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor”.

kanë përmbushur nevojat e hetimit administrativ dhe ribërja e këtyre kërkesave ishte e panevojshme, në kuptim të nenit 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

52. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit në ankim për mosmarrje përgjigje nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës, Bashkia Durrës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mbi të dhënat për aktivitetin dhe të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, M. Ç., që sipas subjektit kanë shërbyer për likuidimin e kësaj pasurie dhe të dytë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se edhe nëse i marrim të mirëqena këto pretendime në vlera, siç pretendon subjekti, përsëri rezultojnë pamjaftueshmëri etë ardhurave të ligjshme për të likuiduar kësaj pasurie e tretë të vlerës së kësaj apartamenti dhe garazhi në vitin 2003.
53. Subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, ka deklaruar si burim krijimi për apartamentin me sipërfaqe 98 m² dhe garazhin me sipërfaqe 22 m² edhe të ardhurat e mbetura nga shitja e apartamentit në qytetin e Durrësit, që referuar përgjigjes së tij ndaj pyetësorit të Komisionit, përbëjnë dhe 65,7 % të vlerës së kësaj pasurie.
Trupi gjykues i Kolegjit, nga analizimi i akteve shkresore (kontratave respektive të shitjes), konstaton se:
- në nenin 4, pika 4.1 e kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., {***} kol., datë 14.04.2003, për apartamentin me sipërfaqe 98 m² dhe nenin 4, pika 4.1 e kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. 1494 rep., nr. 299 kol, datë 16.04.2003, për garazhin me sipërfaqe 22 m², parashikohet se: *shitësi deklaron të jetë likuiduar plotësisht jashtë zyrës së noterisë. Çmimi i shitjes i është paguar sipërmarrësit ndërtues, shoqërisë “{***}” ShPK para redaktimit të kësaj kontrate.* Nisur nga sa përcaktojnë këto kontrata, çmimi i apartamentit dhe garazhit rezultojnë të jenë likuiduar përpara datave 14.04.2003 dhe 16.04.2003.
- referuar kontratës së shitjes nr. {***} rep., {***} kol., datë 21.07.2003, të apartamentit me sipërfaqe 64,46 m² dhe shtesës me sipërfaqe 30 m², ndodhur në rr. “{***}”, Durrës, rezultojnë që subjekti e ka shitur këtë apartament në muajin korrik 2003, ndërkohë që kontrata nr. {***} rep., {***} kol., për blerjen e apartamentit dhe kontrata nr. {***} rep., nr. {***} kol., për blerjen e garazhit, në Tiranë, datojnë mbi 3 muaj më përpara, përkatësisht më datë 14.04.2003 dhe 16.04.2003.
54. Në mbështetje të këtyre fakteve, trupi gjykues arrin në konkluzionin se shitja e apartamentit dhe e shtesës në qytetin e Durrësit, më datë 21.07.2003, nuk mund të ketë shërbyer si burim krijimi për blerjen e apartamentit dhe garazhit, të ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë më datë 14.04.2003 dhe 16.04.2003.
55. Shumica e trupit gjykues vlerëson se arsyetimi i përdorur nga Komisioni lidhur me fshehjen e vlerës së blerjes së apartamentit dhe garazhit në deklaratën e pasurisë të vitit 2003, nuk është i drejtë, pasi në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti dhe personi i lidhur kanë deklaruar vlerën e blerjes sipas dokumentacionit provues ligjor. Me të njëjtin arsyetim, trupi gjykues vlerëson se nuk jemi para kushteve të deklarimit të rremë që kërkon zbatimin e nenit 33, pika 5 germa “ç” e ligjit nr. 84/2016, për arsye se subjekti ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* të ardhurat që ai pretendon se kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, por nga analizimi i dokumentacionit ligjor në dosje rezultoi se ato nuk mund të kenë shërbyer si burim krijimi e, për rrjedhojë, çon në konkluzionin se subjekti nuk disponon të ardhura të ligjshme që mund të shërbejnë për krijimin e kësaj pasurie.

56. Për të vlerësuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të justifikuar pagesën e kështit të tretë me të ardhura nga burime të ligjshme, u krye analiza financiare në Kolegj për periudhën 01.01.2003 – 16.04.2003, nga ku rezultoi mungesë e burimeve financiare të ligjshme në vlerën 1.314.253 lekë, pa konsideruar koston e ndërtimit të shtesës me sipërfaqe 30 m², bërë ngjitur apartamentit me sipërfaqe 64,46 m², me certifikatë pronësie më vete, shitur me kontratë shitjeje nr. {***} rep., kol. {***} kol., më 21.07.2003.

Për këtë pasuri, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

57. Arsyetimi i mësipërm për vlerësimin e kësaj pasurie u bazua në aktet si më poshtë:
- i. Deklarata e pasurisë *vetting* e vitit 2017 dhe dokumentacioni i dorëzuar pranë ILDKPKI-së, më datë 26.01.2017.
 - ii. Deklarata e pasurisë e vitit 2003.
 - iii. Kontratë shitjeje pasuri e paluajtshme nr. rep. {***}, nr. kol. {***}, datë 14.04.2003, me palë shitëse Gjykatën e Apelit Tiranë dhe shoqërinë “{***}” ShPK, për blerjen e apartamentit 98 m².
 - iv. Kontratë shitjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.04.2003, me shitës Gjykata e Apelit, Tiranë dhe shoqëria “{***}” ShPK, për blerjen e garazhit 22 m².
 - v. Kontratë shitjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.07.2003, për shitjen e apartamentit dhe shtesës, të ndodhur në rr. “{***}” nr. 950, Durrës.
 - vi. Shkresë nr. {***} prot., datë 21.06.2018, nga ZVRPP, Tiranë, dhe dokumentacioni bashkëlidhur.
 - vii. Shkresë nr. {***} prot., datë 16.02.2018, e ZVRPP Durrës dhe dokumentacioni bashkëlidhur.
 - viii. Shkresë nr. {***} prot., datë 27.02.2018, e Drejtorisë Rajonale Tatimore, Tiranë.
 - ix. Shkresë nr. {***} prot., datë 27.12.2017, e Drejtorisë Rajonale Tatimore, Durrës.
 - x. Shkresë nr. {***} prot., datë 28.02.2018, e Drejtorisë Rajonale Tatimore, Durrës.
 - xi. Shkresë nr. {***} prot., datë 31.10.2016, e Drejtorisë Rajonale Tatimore, Durrës.
 - xii. Shkresë nr. {***} prot., datë 01.12.2016, e Drejtorisë Rajonale Tatimore, Durrës.
 - xiii. Shkresë nr. *extra* prot., datë 08.02.2018, e shoqërisë “{***}” ShPK.
 - xiv. Dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit.
58. ***Për pasurinë apartament me sipërfaqe 79 m², ndodhur në fshatin {***}, Komuna {***}, Kavajë.***
59. Komisioni, lidhur me këtë pasuri, ka vendosur se subjekti i rivlerësimit: *i) nuk shpjegoi bindshëm se përse çmimi i blerjes së këtij apartamenti është nën koston mesatare të ndërtimit të banesave sipas udhëzimit të vitit 2003, duke pasur parasysh këtu edhe faktin se i njëjti apartament është shitur në vitin 2007 për një vlerë prej 38.000 eurosh; ii) ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues nga burime të ligjshme për vitin 2003, në shumën -3.428.871 lekë, për të blerë këtë apartament; iii) ka bërë deklaram të rremë në lidhje me burimin e krijimit, për shkak se ka deklarime të ndryshme në periudha të ndryshme; iv) ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me këtë apartament.*
60. Subjekti i rivlerësimit Petrit Çeno, këtë pasuri e ka deklaruar në deklaratën e pasurisë të vitit 2003. Si burim krijimi për këtë pasuri, subjekti ka deklaruar: *e blerë nga të ardhurat familjare*, por nuk ka deklaruar vlerën e blerjes së këtij apartamenti.

Në deklaratën e pasurisë *vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur deklarojnë se kjo pasuri është përfituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.07.2003, me shitës B. K. e blerës Petrit Çeno dhe M. Ç., me nr. pasurie {***}, zona kadastrale {***}, vol. {***}, faqe {***}, në vlerën 1.980.000 lekë. Ky apartament nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.05.2007, i është shitur znj. L. M., në vlerën 38000 euro. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit duhet të kishte deklaruar përveç pasurisë, edhe të ardhurat që kanë shërbyer si burim për krijimin e saj. Mosdeklarimi nga ana e subjektit i burimit të krijimit, e klasifikon deklarin si të pasaktë, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

61. Në përgjigje të pyetësorit të Komisionit më datë 18.01.2019, për të specifikuar burimin e krijimit të kësaj pasurie, subjekti deklaron se pagesa e vlerës prej 1.980.000 lekësh është krijuar nga shitja e apartamentit në Durrës, nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.07.2003, në vlerën 5.600.000 lekë.
62. Referuar pikës 3 të kontratës së shitjes nr. {***} rep., {***} kol., datë 01.07.2003, për fitimin e apartamentit 79 m² në {***}, në rubrikën “Çmimi dhe mënyra e pagesës”, është përcaktuar se: 3.1 Palët bien dakord që çmimi i shitjes nga ana e shitësit dhe i blerjes nga ana e blerësit të pronës objekt i kësaj kontrate është 1.980.000 (një milion e nëntëqind e tetëdhjetë mijë) lekë. Kjo shumë është likuiduar nga ana e blerësit në favor të shitësit jashtë zyrës së noterisë. Shitësi deklaron se është likuiduar plotësisht nga blerësi.
63. Subjektit i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se po të analizojmë kontratën e shitjes për apartamentin në Durrës, do të vërejmë se është cituar që pagesa është kryer jashtë zyrës noteriale dhe përpara nënshkrimit të kontratës. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se në përmbajtje të kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.07.2003, në rubrikën “Çmimi i shitjes”, përcaktohet se kjo shumë është likuiduar plotësisht nga blerësi jashtë kësaj zyre noteriale, por nuk specifikohet saktësisht koha e shlyerjes së çmimit të apartamentit, e cila mbetet e papërcaktuar. Duke vlerësuar se jemi në të njëjtën situatë si për apartamentin me sipërfaqe 98 m² të ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, për të cilin po ashtu nga subjekti është pretenduar si burim krijimi të ardhurat nga shitja e apartamentit në qytetin e Durrësit, me të njëjtin arsyetim, trupi gjykues vlerëson se shitja e apartamentit në Durrës, më datë 21.07.2003, nuk mund të ketë shërbyer si burim krijimi për blerjen e apartamentit 79 m² në {***}, Kavajë, më datë 01.07.2003.
64. Sa i përket pretendimit të subjektit se të ardhurat e familjes janë të gjitha të ardhura që vijnë si pasojë e pagave, kursimeve, shitjeve apo marrëdhënieve tregtare që një apo disa pjesëtarë të familjes kanë pasur në kohë, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim nuk është i plotë dhe i mjaftueshëm, referuar kërkesave të ligjit, pasi, nëse u referohemi kërkesave të deklaratës së pasurisë së vitit 2003, në zërin “Burimi” përcaktohet që ai duhet të jetë konkret dhe jo i përgjithshëm. Si rrjedhojë, subjekti duhet të kishte përcaktuar konkretisht burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe të ardhurat familjare duhet të ishin të specifikuar, si të ardhura nga paga, shpërndarje dividendi apo shitja e apartamentit etj.
65. Për të vlerësuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, për të justifikuar me të ardhura nga burime të ligjshme pasurinë apartament me sipërfaqe 79 m², ndodhur në {***}, Kavajë, në Kolegj në të njëjtën qasje me Komisionin u krye analiza financiare e shpenzimeve për periudhën 01.01.2003 - 01.07.2003 që konkretisht konsistojnë në: *pagimin e*

*këstit të tretë për likuidimin e pjesës së mbetur të çmimit të shitjes së apartamentit më 14.04.2003, në vlerën 1.132.000 lekë, në pagimin e këstit të tretë për likuidimin e pjesës së mbetur të çmimit të shitjes së garazhit më 16.04.2003, në vlerën 460.000 lekë, të ndodhura në rr. “{***}” Tiranë, si dhe në likuidimin e çmimit të apartamentit me sipërfaqe 79 m², në {***}, Kavajë, të blerë me kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.07.2003, në vlerën 1.980.000 lekë.*

66. Referuar kësaj analize financiare, rezultoi që për periudhën 01.01.2003 – 01.07.2003, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme financiare, në vlerën 2.705.303 lekë. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se Komisioni, në përfundim të analizës financiare ka konkluduar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën 3.428.871 lekë. Këto ndryshime kanë rezultuar, pasi Komisioni ka përfshirë në analizën e tij periudhën 01.01.2003 – 30.06.2003, ndërkohë që shpenzimet jetike i ka përlllogaritur për gjithë vitin (12 muaj), si dhe nuk ka marrë në konsideratë në analizë ndryshimin e gjendjes së likuiditeteve. Nëse analiza financiare do të jepej e fragmentuar, për periudhën 17.04.2003 – 01.07.2003, mungesa e burimeve financiare të ligjshme, për pagesën e çmimit të apartamentit 79 m² të ndodhur në {***}, do të rezultonte në vlerën 1.391.052 lekë.

Në përfundim, për këtë pasuri, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë në lidhje me burimin e krijimit sipas nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, si dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, sipas nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

67. Arsyetimi i mësipërm për vlerësimin e kësaj pasurie u bazua në aktet si më poshtë.
- i. Deklarata e pasurisë *vetting* e vitit 2017 dhe dokumentacioni bashkëlidhur, dorëzuar nga ILDKPKI, më datë 26.01.2017.
 - ii. Deklarata e pasurisë e vitit 2003.
 - iii. Shkresë nr. {***} prot., datë 12.02.2018, e ZVRPP Kavajë dhe dokumentacioni bashkëlidhur.
 - iv. Kontratë shitblerjeje me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.07.2003, me shitës B. K. dhe blerës Petrit Çeno dhe M. Ç..
 - v. Kontratë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.07.2003, me shitës Petrit Çeno dhe M. Ç. dhe blerës A. B.
 - vi. Kontratë shitblerjeje pasuri e paluajtshme (apartament banimi) nr. {***} rep., {***} kol., datë 08.05.2007, me shitës Petrit Çeno dhe M. Ç. dhe blerës L. M..
 - vii. Dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit.
68. ***Për pasurinë, apartament me sipërfaqe 144 m² dhe garazh me sipërfaqe 20 m² ndodhur në rr. “{***}”, pallati “{***}”, Tiranë.***
69. Për këtë pasuri, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit: *i) ka fshehur vlerën e pasurisë (apartament + garazh), të porositur me kontratën e sipërmarrjes me shoqërinë “{***}” ShPK, në deklaratën e pasurisë “vetting” të vitit 2017, ashtu edhe në deklaratat ndër vite pranë ILDKPKI-së; ii) ka fshehur vlerën reale të detyrimit të mbetur shoqërisë. Detyrimi i mbetur, referuar pagesave të deklaruara nga subjekti, rezulton të jetë në vlerën 27.000 euro, ndërsa sipas deklarimeve ndër vite dhe deklaramit nga ana e shoqërisë, rezulton të jetë në vlerën 19.000 euro. Ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor nga ana e subjektit, në lidhje me pagesat e kryera. iii) Ka kryer deklaram të rremë në lidhje me likuidimet ndaj shoqërisë “{***}” ShPK për blerjen e apartamentit dhe garazhit, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur nga vetë shoqëria “{***}” ShPK, pagesa e parë me këtë shoqëri është bërë në vitin 2008, në shumën 3.700.000 lekë,*

ndërsa është deklaruar nga subjekti si pagesë e bërë në vitin 2009; iv) ka mungesë burimesh të ligjshme financiare në vitin 2008, për pagesën e shumës 3.700.000 lekë ose rreth 30.000 euro.

70. Nga shqyrtimi i akteve shkresore të dosjes gjyqësore, trupi gjykues vëren se më datë 14.02.2009, shoqëria “{***}” ShPK dhe bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. M. Ç., kanë nënshkruar një kontratë sipërmarrjeje, me objekt blerje apartamenti me sipërfaqe 143,75 m² dhe garazhi me sipërfaqe 20 m², respektivisht për apartamentin në vlerë 172.500 euro dhe për garazhin 24.000 euro, në vlerën 196.500 euro në total. Sipas përcaktimeve të kontratës, porositësi, në këtë rast bashkëshortja e subjektit, i likuidon sipërmarrësit në momentin e firmosjes së kontratës së sipërmarrjes vlerën prej 49.176 eurosh, këstin e dytë prej 40.000 eurosh do ta likuidonte brenda muajit maj 2009, dhe diferencën prej 107.333 eurosh do ta likuidonte brenda muajve gusht-tetor 2009.
71. Për herë të parë kjo pasuri është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë në vitin 2009, si vijon: *Me kontratën e sipërmarrjes datë 14.02.2009, lidhur me firmën e ndërtimit “{***}” ShPK, Tiranë, kemi prenotuar një apartament dhe një garazh, për të cilin kemi paguar 49.174 euro, më datë 14.02.2009. Pra kemi pakësim të gjendjes cash 30.000 euro dhe 2.500.000 lekë, të konvertuara këto të fundit në euro në datën 14.02.2009 me 126,5 lekë, e barabartë me 19.825 euro. Këto të holla kanë qenë të deklaruara më parë. Pasuria më sipër është deklaruar edhe nga personi i lidhur në të njëjtën deklaratë të interesave privatë të vitit 2009, ku deklarohet: Me kontratën e sipërmarrjes, datë 14.02.2009, lidhur me firmën e ndërtimit “{***}” ShPK Tiranë, kam prenotuar një apartament dhe një garazh, ku janë paguar më datë 14.02.2009, 49.170 euro. Bashkëlidhur një kopje të kontratës. Pjesa takuese 100%.*
Në këtë deklaratë subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar çmimin e apartamentit dhe garazhit në vlerën 196.500 euro në total dhe detyrimet financiare të mbetura ndaj shoqërisë.
72. Në deklaratën e pasurisë *vetting* 2017, bashkëshortja e subjektit deklarohet: *[...]Në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes janë paguar 49.000 euro, të ardhura të cilat janë krijuar nga kursimet e familjes deri në atë moment. Kësti i dytë prej 60.000 eurosh është paguar nëpërmjet kredisë marrë pranë Bankës Alpha, dega Durrës, sipas kontratës së huas nr. {***}, datë 28.01.2010, me nr. {***} rep., nr. {***} kol, datë 12.02.2009. Kredia e marrë në vlerën 60.000 euro, vlerë e cila i ka kaluar shoqërisë “{***}” ShPK. Kësti i tretë është paguar në shumën prej 60.000 eurosh në vitin 2014, shumë e cila është krijuar pjesërisht nga kontrata e shitblerjes së një banese me nr. {***} rep {***}, datë 12 shkurt 2013 me palë shitëse M. Ç. dhe palë blerëse R. Ç., në vlerën 5.349.143 lekë dhe pjesa e mbetur nga kontrata e shitblerjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.11.2014. me palë shitëse M. Ç. dhe palë blerëse E. dhe K. K., në vlerën 95.000 euro. Pjesa e mbetur e shumës do të paguhet në momentin e regjistrimit të pronës në ZRPP.*
73. Trupi gjykues, nga analizimi i deklaratës së pasurisë *vetting* 2017, konstaton se bashkëshortja e subjektit nuk ka deklaruar çmimin e apartamentit dhe garazhit në këtë deklaratë dhe as detyrimin financiar të mbetur pashlyer ndaj shoqërisë “{***}” ShPK. Bazuar në nenin 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të plotësojnë deklaratën e pasurisë *vetting*, sipas shtojcës bashkëlidhur këtij ligji. Nisur nga fakti që subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar deklaratën e pasurisë për rivlerësim *vetting*, me të gjitha elementet sipas këtij përcaktimi ligjor, trupi gjykues vlerëson se deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin, sipas përcaktimit në nenin 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

74. Komisioni me shkresën nr. {***} prot., datë 27.07.2018, i ka kërkuar informacion dhe dokumentacion shoqërisë “{***}” ShPK, lidhur me pyetjen nëse subjekti dhe personat e lidhur me të kanë porositur apo blerë pasuri të paluajtshme pranë kësaj shoqërie, vlerën konkrete të tyre, shumat e paguara dhe detyrimet e mbetura, të shoqëruara me kopje dokumentacioni, si kontratë, marrëveshje, mandatpagesa etj.

75. Shoqëria “{***}” ShPK, në përgjigje të shkresës së Komisionit (protokolluar me nr. {***}, datë 6.8.2018), ndër të tjera ka përcjellë dhe 13 mandatar-këtime me numër rendor *extra*: i) 5 mandatar-këtime në lekë, për pagesën e kështit të parë në vlerën 6200000 lekë, konvertuar në 49.167 euro sipas kursit (1 euro = 126,1 lekë) për pagesat nga data 08.11.2008 deri 31.01.2009; ii) 8 mandatar-këtime në euro për pagesën e kështit të tretë në vlerën 42000 euro, për pagesat e kryera nga data 07.01.2015 deri 03.11.2015; si dhe iii) transfertën bankare nga Alpha Bank (nëpërmjet kredisë) në Bankën Kombëtare Tregtare ShA në vlerën 58600 euro për pagesën e kështit të dytë, datë 03.03.2010.

Shoqëria “{***}” ShPK deklaron se deri në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes më 14.02.2009, shuma totale e pagesave të kryera nga bashkëshortja e subjektit ishte 6200000 lekë = 49.167 euro, e konvertuar me kursin 126,10 ALL/EUR, shlyejnë kështin e parë të apartamentit dhe garazhit. Shuma 58600 euro, e paguar më 03.03.2010 në BKT ShA, shlyen kështin e dytë të çmimit të pasurive objekt shqyrtimi dhe *pagesat e tjera janë kryer në mirëkuptim, pa respektuar afatet*, sipas deklarimeve të shoqërisë në përgjigjen drejtuar Komisionit.

Në vijim, shoqëria e ndërtimit “{***}” ShPK sqaron se *shuma e paguar nga klienti është 172226 euro* (deri më 27.07.2018, datë në të cilën i përgjigjet kërkesës për informacion të Komisionit), por, *disa mandatpagesa që plotësojnë vlerën e likuiduar 172226 euro mungojnë*. Sipas shkresës së shoqërisë, nuk është paguar nga porositësi vlera 19650 euro (10% e vlerës, si kësht i fundit deri në hipotekimin e apartamentit), si dhe janë zbritur nga vlera totale e apartamentit 6083 euro, për punime të kryera nga porositësi me pagesën e tij.

76. Nga analizimi i dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria sipërmarrëse “{***}” ShPK, si dhe deklaratimet e bëra prej kësaj shoqërie, rezulton të jetë administruar dokumentacioni justifikues financiar e ligjor vetëm për shumën 149.767 euro (49.167 euro + 58.600 euro + 42.000 euro) nga shuma 172.226 euro, që shoqëria deklaron t’i jetë likuiduar nga porositësja M. Ç..

Lidhur me sa sipër, nëse shoqëria sipërmarrëse “{***}” ShPK ka deklaruar saktë në përgjigjen e dhënë kërkesës për informacion dhe dokumentacion të Komisionit nr. {***} prot., datë 27.07.2018, për *pagesat e M. Ç.*, atëherë duhet të kishte paraqitur edhe dokumentacion justifikues financiar, evidencën mbështetëse mbi të cilën ka bërë regjistrimet kontabël, në zbatim të nenit 6 të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, të cilat mbahen si provë dokumentare dhe ruhen për 10 vjet pas mbylljes së vitit ushtrimor të cilit i përkasin, përveç atyre për të cilat me ligj ose akt tjetër nënligjor, përcaktohet një afat më i gjatë ruajtjeje, sipas përcaktimeve të nenit 17⁷ të ligjit të sipërcituar. Po kështu referuar pikës 48⁸ të

⁷Neni 17 i ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, i ndryshuar: “Regjistrat kontabël dhe evidencat mbështetëse ruhen për 10 vjet rresht pas mbylljes së vitit ushtrimor kontabël, të cilit i përkasin, përveç atyre që me ligj ose akt tjetër nënligjor, përcaktohet një afat më i gjatë ruajtjeje. I njëjti afat zbatohet edhe për dokumentet informatike (bartësit) dhe printimet e tyre”.

⁸Pika 48 e udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, “Afati i ruajtjes së dokumentacionit”:

“48.1 Tatimpaguesi është i detyruar të mbajë regjistrat, librat dhe skedarë elektronikë ose manual që përmbajnë informacionin financiar të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të veprimeve tregtare e biznesore të tatimpaguesit, në përputhje me legjislacionin për kontabilitetin dhe legjislacionin tatimor.

udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, të ministrit të Financave “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, informacioni financiar e kontabël ruhet nga tatimpaguesi të paktën 5 vjet.

Referuar përcaktimeve ligjore më sipër, duke marrë në konsideratë dhe periudhën (viti 2015) kur janë kryer pagesat sipas informacionit të dërguar nga shoqëria “{***}” ShPK, trupi gjykues vlerëson se kjo e fundit ka pasur mundësi për të evidentuar me dokumentacion provues të gjitha pagesat e kryera nga personi i lidhur për sa i përket shlyerjes së këstit të tretë.

77. Lidhur me kohën e pagesës së këstit të parë, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja në deklaratën interesave privatë të vitit 2009 deklarojnë se shuma prej 49174 eurosh është paguar më 14.02.2009, që përkon dhe me datën e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes. I njëjti deklaram është bërë dhe nga bashkëshortja e subjektit në deklaratën e pasurisë *vetting*, ku deklararon: [...] *Në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes janë paguar 49.000 euro, të cilat janë krijuar nga kursimet e familjes deri në atë moment [...].* Shoqëria “{***}” ShPK, në informacionin e përcjellë pranë Komisionit, përcakton se: *Pagesat për shoqërinë “{***}” nga porositësi M. Ç. për prenotimin e apartamentit + garazh deri në momentin e lidhjes së kontratës më datë 14.02.2009.*

1.200.000 lekë – 08.11.2008

1.400.000 lekë – 01.12.2008

1.100.000 lekë – 20.12.2008

1.300.000 lekë – 15.01.2009

1.200.000 lekë – 31.01.2009

Këto fatura shlyejnë këstin e parë të kontratës së sipërmarrjes të datës 14.02.2009, të konvertuara me kursin 126,1 euro = 49167 euro [...].

78. Nisur nga informacioni i përcjellë nga shoqëria dhe mandatarkëtimet e vëna në dispozicion nga vetë subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit më datë 18.01.2019, rezulton se vlera prej 3.700.000 lekësh është paguar në vitin 2008 dhe vlera prej 2.500.000 lekësh gjatë vitit 2009, të gjitha të paguara para nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes.
79. Në mbështetje të dokumentacionit të analizuar më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë në lidhje me kohën e likuidimit të këstit të parë ndaj shoqërisë “{***}” ShPK, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria dhe vetë subjekti rezulton se pagesa e parë me këtë shoqëri është bërë në vitin 2008, në shumën 3.700.000 lekë, ndërsa në deklaratën e pasurisë *vetting* është deklaruar se pagesa e këstit të parë është bërë në momentin e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes, datë 14.02.2009. Sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, sa i përket këstit të parë, ka kryer deklaram të rremë lidhur me kohën e likuidimit të tij, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016.

48.2 sipas pikës 2 të nenit 48 të Ligjit të dhënat dhe informacioni financiar e kontabël ruhen nga personat e tatueshëm për të paktën 5 vjet, duke filluar nga fundi i vitit ushtrimor, të cilit i përkasin dokumentet. Dokumentacioni bazë si faturat tatimore të TVSH-së dhe faturat e thjeshta tatimore, regjistrat dhe të gjitha regjistrimet e bëra në këto regjistra, librat kontabël dhe të gjitha regjistrimet e bëra në këto libra, të cilat mbahen siç përcaktohet në ligjin “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, raportet financiare, librat e shitjes dhe librat e blerjes, të cilat mbahen siç përcaktohet në Ligjin “Për TVSH” dhe në udhëzimin në zbatim të tij, ruhen për të paktën 5-vjet, duke filluar nga fundi i vitit ushtrimor në të cilin ato janë lëshuar [...].”

80. *Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se krijimi i vlerës prej 49000 eurosh ka ardhur: 8000 euro nga pjesa e mbetur nga shitja e shtëpisë në {***}, shitur në vlerën 38000 euro, pjesa tjetër nga kursimet e familjes të deklaruara ndër vite. (viti 2005 - 1.755.000 lekë;viti 2006 – 1.100.000 lekë; viti 2007 – 1.280.000 lekë; viti 2008 – 1.300.000 lekë;viti 2009 – 1.900.000 lekë. Të cilat në total ishin 7.335.000 lekë (përafërsisht 62.000 euro kursime nga viti 2005-2009). Këto kursime janë shpenzuar pjesërisht për pagimin e shumës 49.000 euro dhe pjesa tjetër ka mbetur kursim i familjes. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, nuk kanë justifikuar kursimet e deklaruara në vitet 2005, 2006 dhe 2009 me të ardhura nga burime të ligjshme.*
81. *Nga krahasimi i deklarimeve të kryera në deklaratat e interesave privatë periodikë me dokumentacionin provues ligjor, shkresa nr. {***} prot., datë 27.12.2017, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, administruar në ILDKPKI, dhe shkresa nr. {***} prot., datë 31.10.2016, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, e përcjellë nga vetë subjekti, trupi gjykues konstaton se subjekti ka pasaktësi në deklaratimet e tij ndër vite në lidhje me të ardhurat e bashkëshortes si ortakë me 11,11% të aksioneve pranë shoqërisë “{***}” ShPK, duke deklaruar të ardhura më të larta sesa konfirmohet me dokumentacion.*
82. *Duke marrë në konsideratë burimin e krijimit të këstit të parë të deklaruar nga bashkëshortja në deklaratën e pasurisë vetting 2017, si kursimet e familjes deri në atë moment, si dhe pretendimit në shkaqet e ankimit se si burim krijimi për të likuiduar këstin e parë kanë shërbyer dhe kursimet familjare të viteve 2005, 2006, 2007, 2008 dhe 2009, nga analiza financiare e kryer në Kolegj rezultoi se në vitin 2008 subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur mungesë të burimeve financiare për shlyerjen e vlerës prej 3.700.000 lekësh, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.*
83. *Lidhur me pagesën e këstit të tretë të çmimit, subjekti pretendon në ankim se krijimi i vlerës prej 60.000 eurosh ka ardhur: nga tërheqja e shumës 22.000 GBP nga Banka Raiffeisen e konvertuar në atë periudhë në 4.000.000 lekë, nga kursimet familjare të vitit 2014 në vlerën 2.500.000 lekë, të cilat në total janë 6.500.000 lekë. Në vitin 2013 është deklaruar shitje e apartamentit në vlerën 5.349.143 lekë, i cili bashkë me kursimet e vitit shkon përafërsisht 6.000.000 lekë, kjo pjesërisht u konvertua në 33.000 GBP, të cilat në vitin 2014 u depozituan në Raiffeisen Bank, më pas u tërhoqën. Për shkollimin e vajzës u përdorën 11.000 GBP dhe 22.000 GBP u konvertuan në lekë dhe u përdorën për pagesën e këstit të tretë së bashku me pjesën tjetër të kursimeve.*

Referuar këtij pretendimi dhe në analizë të deklaratave të pasurisë të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, trupi gjykues konstaton se:

- *Në deklaratat e interesave privatë të viteve 2010, 2011, 2012 dhe 2013, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar detyrimin financiar të mbetur pashlyer ndaj shoqërisë “{***}” ShPK.*
- *Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit deklaroi: Detyrime për firmën “{***}” ShPK – Tiranë për apartament banimi, nga kontrata e sipërmarrjes e deklaruar më parë. Gjendje e detyrimit të mbetur pashlyer në vlerën 79.000 euro.*
- *Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2015, subjekti i rivlerësimit deklaroi të shlyer ndaj shoqërisë “{***}” ShPK vlerën prej 60.000 eurosh dhe detyrim të mbetur në vlerën 19.000 euro.*
- *Në deklaratën e pasurisë vetting, personi i lidhur deklaroi: [...] Kësti i tretë është paguar në shumën prej 60.000 eurosh në vitin 2014 [...].*

Sa më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë mbajtur qëndrime kontradiktore për vitin në të cilin është paguar kësti i tretë në vlerën prej 60.000 eurosh, pasi subjekti në deklaratën e interesave private të vitit 2015 deklaroi se ky këst është paguar në vitin 2015, ndërsa personi i lidhur në deklaratën e pasurisë *vetting* deklaroi se kësti i tretë është paguar në vitin 2014.

84. Për sa i përket burimit të krijimit të këstit të tretë në vlerën 60.000 euro, sipas deklaratës së interesave private të vitit 2015 të subjektit të rivlerësimit, kjo vlerë është krijuar, një pjesë nga pakësimi i gjendjes *cash* të deklaruar në vitin 2014 (6.500.000 lekë ose 47.000 euro), një pjesë nga shitja e automjetit me targë {***} në vlerën 4.000 euro dhe shuma prej 1.350.000 lekësh e përfituar nga kursimet e të ardhurave familjare në vitin 2015, e konvertuar në 9.000 euro.

Në deklaratën e pasurisë *vetting* bashkëshortja e subjektit deklaroi se kësti i tretë është paguar në shumën prej 60.000 eurosh në vitin 2014, shumë e cila është krijuar pjesërisht nga kontrata e shitblerjes së një banese me nr. {***} rep., datë 12 shkurt 2013, me palë shitëse M. Ç. dhe palë blerëse R. C. me vlerë 5.349.143 lekë dhe pjesa e mbetur nga kontrata e shitblerjes me nr. {***} rep., {***} kol., datë 18.11.2014, me palë shitëse M. Ç. dhe palë blerëse E. dhe K. K. në shumën 95.000 euro.

Po në deklaratën e pasurisë *vetting*, personi i lidhur, bashkëshortja, deklaroi: Në vitin 2014, nga shitja e një apartamenti nëpërmjet kontratës nr. {***} rep., {***} kol., datë 18.11.2014, me palë shitëse M. C. dhe palë blerëse E. K. dhe K. K. në vlerën 95.000 euro, kjo vlerë është shtuar automatikisht në llogarinë bankare pranë bankës Intesa Sanpaolo, më datë 27.11.2014, nga kjo llogari më datë 05.12.2014 është tërhequr shuma prej 35.000 eurosh (prej të cilave 10.000 euro është paguar kësti i fundit kundrejt firmës {***} ShPK [...] dhe 22.200 euro nga tërheqja është bërë pjesërisht pagesa e këstit të tretë për apartamentin e blerë me kontratën e sipërmarrjes së lidhur më datë 14.02.2009.

Sa më sipër, nuk përputhen pretendimet e subjektit të rivlerësimit në ankim, për sa i përket burimit të krijimit të këstit të tretë në vlerën 60.000 euro, me deklaratimet e bashkëshortes në deklaratën e pasurisë *vetting*.

85. Nisur nga deklaratimet e personit të lidhur, bashkëshortes, në deklaratën e pasurisë *vetting* 2017, se shuma prej 60.000 eurosh për të shlyer këstin e tretë të pagesës për apartamentin me sipërfaqe 144 m² dhe garazhin me sipërfaqe 20 m², ndodhur në rr. “{***}”, pallati “{***}”, Tiranë, ka si burim krijimi të ardhurat nga kontrata e shitblerjes së një banese me nr. {***} rep., datë 12 shkurt 2013, me palë shitëse M. Ç. dhe palë blerëse R. C., me vlerë 5.349.143 lekë dhe pjesa e mbetur nga kontrata e shitblerjes me nr. {***} rep., {***} kol., datë 18.11.2014, me palë shitëse M. Ç. dhe palë blerëse E. dhe K. K., në shumën 95.000 euro, trupi gjykues mori në analizë dokumentacionin e këtyre dy pasurive që kanë shërbyer si burim krijimi, duke pasur në vëmendje edhe pretendimet e subjektit në ankim, dhe konstaton sa vijon.

- a) Të ardhurat nga shitja e apartamentit të ndodhur në {***}, Durrës, me anë të kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.02.2013, me palë shitëse M. Ç. dhe palë blerëse R. Ç., në vlerën 5.349.143 lekë.

85.1. Lidhur me origjinën e këtij apartamenti të ndodhur në {***}, Durrës, që ka shërbyer si burim krijimi për apartamentin dhe garazhin në rrugën “{***}”, Tiranë, përfshirë në këstin e tretë, trupi gjykues vëren si vijon.

85.2. Nga analizimi i akteve shkresore në dosjen gjyqësore, konstatohet se bashkëshortja e subjektit, znj. M. Ç., si ish-punonjëse e Ndërmarrjes Bujqësore Frutore Durrës, ka përfituar nga ligji nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”, i ndryshuar, dy sipërfaqe tokë ullishte sipas dy AMTP⁹, përkatësisht AMTP nr. {***}, datë 22.09.1999 dhe AMTP nr. {***}, datë 2.2.1999, përkatësisht 3350 m² dhe 3000 m² të ndodhura në {***}, Durrës, të regjistruara pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Durrës.

85.3. Nga shqyrtimi i akteve shkresore, trupi gjykues konstaton se për sipërfaqen prej 2775 m², me nr. pasurie {***}, është nënshkruar kontratë për sipërmarrje dhe investime ndërtimore nr. {***} rep., nr. {***} kol, datë 21.01.2009, dhe kontratë aneks nr. {***} rep., nr. {***} kol, datë 14.11.2009, ndërmjet znj. M. Ç. në cilësinë e palës porositëse dhe shoqërisë ndërtimore “{***}” ShPK për ndërtimin e një godine banimi shumëkatëshe. Sipas kësaj kontrate, M. Ç. do të jetë përfituese e 23% të sipërfaqes ndërtimore, godinës shumëkatëshe që i përket sipërfaqes së truallit të vënë në dispozicion, duke u shtrirë ky koeficient përfitimi nga ndërtimi nën tokë, garazhet, lokalet apo ambientet e shërbimit dhe apartamentet e banimit, të ndërtuara mbi lokalet, pra në të gjithë lartësinë e godinës, ndërsa pala porositëse (pronari i truallit) do t’i tjetërsojë me shkëmbim në pronësi palës sipërmarrëse, shoqërisë “{***}” ShPK, të gjithë sipërfaqen e tokës 2775 m², duke i njohur të drejtën e pronësisë për 77% të sipërfaqes ndërtimore të objektit të ndërtuar.

85.4. Me anë të kontratës për shkëmbimin e pasurive të paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.12.2011, M. Ç. përfiton me shkëmbim nga shoqëria “{***}” ShPK këto pjesë të godinës së banimit dhe shërbimit 7 kate, plus 1 kat parkim, plus 1 kat shërbim + papafingo, si më poshtë:

1. *garazhi G8, me sipërfaqe 77 m², pasuria nr. {***};*
2. *njësia nr. {***}, kati përdhe, me sipërfaqe 68 m², pasuria nr. {***};*
3. *apartamenti nr. {***}, kati i pestë, me sipërfaqe 96,19 m², pasuria nr. {***};*
4. *apartamenti nr. {***}, kati i pestë, me sipërfaqe 63,35 m², pasuria nr. {***} (Ky apartament është shitur me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.06.2016, në vlerën 25.000 euro.);*
5. *apartamenti nr. {***}, kati i pestë, sipërfaqe 103,31 m², pasuria nr. {***} (Ky apartament është shitur me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.02.2013, në vlerën 5349.143 lekë);*
6. *apartamenti nr. {***}, kati i pestë, sipërfaqe 98,02 m², pasuria nr. {***};*
7. *apartamenti nr. {***}, kati tetë, sipërfaqe 111,56 m², pasuria nr. {***} që është papafingo dhe ambiente ndihmëse, përfshirë dhe tarracën e shfrytëzueshme 158,1 m².*

Referuar sa më sipër, shitja e apartamentit nr. {***}, me sipërfaqe 103,31 m², pasuria nr. {***}, me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.02.2013, në vlerën 5349.143 lekë, ka shërbyer si një nga burimet e krijimit të pasurisë apartament dhe garazh, ndodhur në rr. “{***}”, pallati “{***}”, Tiranë.

85.5. Nga shqyrtimi i procesit të rivlerësimit në Komision, lidhur me dy sipërfaqet e tokës (ullishte), trupi gjykues i Kolegjit konstaton se nga hetimi administrativ i zhvilluar në Komision, ka rezultuar një mospërputhje mes dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit me përgjigjet e pyetësorit dhe dokumentacionit të përcjellë nga ZVRPP, Durrës, më konkretisht: ZVRPP, Durrës, me shkresën nr. {***} prot., datë 03.08.2018, informon se nga verifikimi i

⁹AMTP- akronim për “Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi”.

sistemit dixhital të pasurive të paluajtshme, rezulton se në emër të M. Ll. është regjistruar një pasuri në zonën kadastrale {***}, e përfituar me AMTP nr. {***} të fshatit {***}. Në kartelat e pasurisë së paluajtshme që i përkasin zonës kadastrale {***}, nr. pasurie {***}, vol {***}, f. {***}, rezulton ullishte me sipërfaqe 3.000 m² (nr. dok.akti {***}) në emër të znj. M. Ll., data e regjistrimit të pasurisë në ZVRPP Durrës 03.02.2000. Po kështu në kartelën e pasurisë ullishte, të ndodhur në zonën kadastrale {***}, nr. pasurie {***}, vol. {***}, f. {***}, vijon në vol. {***}, f. {***}, rezulton e regjistruar 3350 m², ref. akti {***}, pasuri e regjistruar më datë 12.03.1999, në emër të znj. M. Ll..

Nëse i referohemi përmbajtjes së AMTP-së nr. {***}, të përcjellë nga ZVRPP, Durrës, me shkresën e sipërcituar, rezulton se me anë të këtij akti të marrjes së tokës në pronësi i është dhënë tokë 3200 m² në fshatin {***}, Durrës, më datë 09.09.1993, z. B. M..

85.6. Komisioni në vendimin nr. {***}, datë 27.02.2019, ka dalë në përfundimin se për pasurinë tokë ullishte, me sipërfaqe 3000 m² dhe sipërfaqe 2775 m², në {***} Durrës, subjekti i rivlerësimit nuk provoi me anë të shpjegimeve apo dokumenteve mospërputhjet që ekzistonin midis deklaratimit të tij dhe dokumentacionit të administruar në dosje, për mënyrën e fitimit të kësaj pasurie. Në lidhje me këtë pasuri, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se Komisioni nuk ka dalë në një përfundim, sipas nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

*b) Të ardhurat nga shitja e apartamentit në {***} me kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.11.2014, me palë shitëse M. Ç. dhe palë blerëse E. dhe K. K., në shumën 95.000 euro, që kanë shërbyer si burim krijimi për këstin e tretë, për pasurinë ndodhur në rrugën “{***}” në Tiranë.*

85.7. Nga analizimi i dokumentacionit të dosjes, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se me anë të aktmarrëveshjes të datës 06.06.2007, të nënshkruar mes shoqërisë “{***}” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit dhe znj. M. Ç. në cilësinë e porositësit, sipërmarrësi në bazë të lejes së ndërtimit¹⁰ do të ndërtojë objektin në kompleksin turistik me vila individuale dhe të përbashkëta (3-katëshe), si dhe vende parkimi të hapura mbi truallin në parcelën bregdetare 6/1 në {***}, Kavajë. Objekt i kësaj aktmarrëveshjeje janë: 1. apartamenti nr. {***} i vilës së përbashkët nr. {***}, me sipërfaqe aktuale ndërtimi 84,26 m² e sipërfaqe aktuale totale 91,51 m² i ndodhur në katin përdhe me oborr 61 m²; 2. vend parkimi nr. {***}, me sipërfaqe 12,5 m², i ndodhur në oborin e përbashkët pranë vilës.

Bazuar në nenet 2 dhe 3 të aktmarrëveshjes, çmimi i apartamentit, oborrit dhe vendit të parkimit është 55.000 euro, pagesa e të cilit do të bëhet në dy këste. Kësti i parë prej 30.000 eurosh është paguar në momentin e nënshkrimit të aktmarrëveshjes dhe kësti i dytë prej 25.000 eurosh do të paguhet në një periudhë të mëvonshme që do të përcaktohet bashkërisht.

85.8. E drejta e pronësisë mbi truallin e kësaj pasurie është fituar me kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.01.2012, të nënshkruar mes Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe znj. M. Ç., në vlerën prej 158.412 lekësh. Subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar fitimin e pronësisë së truallit dhe vlerën e tij në deklaratën e interesave privatë të vitit 2012. Në përfundim të procedurave të legalizimit të ndjekura nga ALUIZNI, me lejen e legalizimit nr. 9579, datë 18.04.2012, legalizohet objekti godinë banimi, me 3 kate, në emër të 6 personave, pjesë e të cilit është dhe apartamenti në emër të bashkëshortes së subjektit, znj. M. Ç.

¹⁰Leje e ndërtimit nr. {***}, datë 23.04.2004, e lëshuar në zbatim të vendimit të K.RR.T.R.Sh nr. 5, datë 18.06.2003.

85.9. Me shkresën nr. {***} prot., datë 19.04.2012, ALUIZNI përcjell pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Kavajë, dokumentacionin tekniko-ligjor për regjistrim fillestar të pasurive të paluajtshme. ZVRPP Kavajë, me shkresën nr. {***} prot., datë 12.02.2018, drejtuar Komisionit, konfirmon se në emër të znj. M. Ç. ka qenë e regjistruar pasuria me nr. {***} volum {***}, faqe {***}, zona kadastrale {***}, apartament me sipërfaqe 81,6 m², si dhe pjesa takuese e truallit në pasurinë {***} volum {***}, faqe {***}.

85.10. Me kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.11.2014, ky apartament me sipërfaqe 81,6 m² dhe kuotë pjesëmarrjeje prej 25,1%, e shprehur në metra 157,53 m² (vërtetuar me certifikatën për vërtetim pronësie nr. {***}, lëshuar më datë 11.06.2012) i shitet E. K. dhe K. K. në vlerën 95.000 euro.

85.11. Nga analizimi i deklaramëve të subjektit dhe personit të lidhur, për këtë pasuri, trupi gjykues konstaton:

- Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2007 nuk është deklaruar aktmarrëveshja me shoqërinë “{***}” ShPK, shlyerja e kështit të parë prej 30.000 eurosh, si dhe detyrimi i mbetur në vlerën 25.000 euro, sipas parashikimeve në aktmarrëveshje.
- Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2011 është deklaruar për herë të parë kjo pasuri nga subjekti: *Pronotuar një ap. sip. 83,8 m² në {***}, Kavajë, me vlerë 55.000 euro. Pagesë e bërë nga pakësimi i gjendjes cash të deklaruar në vitet 2008-2009-2010, shuma e paguar 30.000 euro.*
- Në deklaratën e pasurisë “vetting”, bashkëshortja e subjektit deklaroi: *Nëpërmjet aktmarrëveshjes, datë 06.06.2007, është blerë apartamenti mbi truallin në parcelën bregdetare 6/1, në {***}, Kavajë, me palë shitëse P. C., përfaqësues i shoqërisë së ndërtimit {***} ShPK, dhe palë blerëse M. Ç., në vlerën 55.000 euro. Kjo pronë është shitur me kontratën nr. {***} rep., {***} kol., datë 18.11.2014, me palë shitëse M. Ç. dhe palë blerëse E. K. dhe K. K. në vlerën 95.000 euro.*

85.12. Pretendimin e subjektit në ankim se, për shkak të harresës, kjo kontratë është deklaruar një vit më pas dhe në deklarimin e atij viti është shprehur se kjo kontratë është nënshkruar një vit më parë, trupi gjykues e gjen të pabazuar. Referuar nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, deklarimi ka për qëllim pikërisht verifikimin e burimeve të ligjshme financiare për krijimin e pasurive në vitin deklarues. Kjo pasuri nuk është deklaruar një vit më vonë siç pretendon subjekti, as në vitin 2009 apo 2010, por në deklaratën e interesave privatë të vitit 2011, katër vjet më pas. Subjekti i rivlerësimit duhet të kishte deklaruar në vitin 2007, që korrespondon me momentin e nënshkrimit të aktmarrëveshjes.

85.13. Nga analizimi i dokumentacionit të dosjes gjyqësore në lidhje me mënyrën e pagesës së vlerës së kësaj pasurie, trupi gjykues konstaton:

- Në aktmarrëveshje parashikohet që kësti i parë në vlerën 30.000 euro do të paguhet në momentin e nënshkrimit të saj, pra më datë 06.06.2007.
- Në vërtetimin e lëshuar nga shoqëria “{***}” ShPK, nr. {***} prot., datë 15.01.2019, të depozituar nga vetë subjekti gjatë hetimit administrativ, përcaktohet se pagesa e parë është bërë më datë 08.06.2007.

- Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2011, ashtu dhe në shkakun e ankimit të subjektit, pretendohet se pagesa e këstit të parë është bërë në vitin 2011, nga kursimet e viteve 2008-2009-2010.
 - Subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit të Komisionit deklaron: [...] nga vërtetimi nr. 001, datë 15.01.2019 i lëshuar nga shoqëria {***} ShPK, pasi unë në arkivat e mia nuk kisha në dispozicion asnjë mandatarkëtim. Gjithashtu ky vërtetim jep të detajuar pagesat e bëra nga ana jonë për shoqërinë {***} ShPK në lidhje me apartamentin e sipërcituar.
 - Sa i përket pagesës së këstit të dytë prej 25.000 eurosh, sipas vërtetimit të shoqërisë “{***}” ShPK, pagesa prej 15.000 eurosh është bërë më datë 19.12.2011 dhe pagesa e tretë prej 10.000 eurosh më datë 12.12.2014.
 - Ndërsa subjekti i rivlerësimit, ndryshe nga informacioni i vërtetimit të lëshuar nga shoqëria, pagesën e këstit të dytë prej 15.000 eurosh, e deklaron në deklaratën e interesave privatë të vitit 2012, sipas së cilës ka shlyer detyrimin në vlerën 15.000 euro dhe detyrimi i pashlyer mbetet në vlerën 10.000 euro, ndërkohë që në përgjigje të pyetësorit subjekti i rivlerësimit deklaron: *Kësti i dytë i paguar më datë 19.12.2011 është në vlerën 15.000 euro, vlerë të cilën mund ta verifikoni nga deklarimi për vitin 2011, i depozituar në 2012, gjithashtu dhe nga vërtetimi nr. prot. {***}, datë 15.01.2019, i lëshuar nga shoqëria {***} ShPK [...].*
86. Trupi gjykues i Kolegjit, referuar parashikimit ligjor të përcaktuar në nenin 4, germat “a” dhe “dh” të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, se: *Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave privatë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil [...]; dh) detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj [...], vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur këtë detyrim ligjor, pasi nuk ka deklaruar në deklaratën e interesave privatë të vitit 2007, nënshkrimin e aktmarrëveshjes me shoqërinë “{***}” ShPK për apartamentin me sipërfaqe 91,51 m², ndodhur në {***}, si dhe burimin e të ardhurave për pagesën e këstit të parë në vitin 2007, në vlerën prej 30.000 euro. Nisur nga fakti që të ardhurat që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie nuk janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratimet vjetore periodike, të krijuhet bindja se nuk janë përfituar në mënyrë të ligjshme. Pra, mosdeklarimi në deklaratat e interesave privatë vjetorë nga ana e subjektit, në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit, veson ligjshmërinë e krijimit të kësaj pasurie, e cila në deklaratën e pasurisë *vetting* është deklaruar si burim krijimi për pagesën e këstit të tretë të apartamentit dhe garazhit në rrugën “{***}”, pallati “{***}”, Tiranë. Për këtë arsye, trupi gjykues i Kolegjit konkludon se subjekti ka përdorur një mënyrë të paligjshme për të krijuar të ardhurat, pasi nuk provohet e kundërta për shkak të mungesës së provueshmërisë që vjen nga mungesa e deklarimeve në deklaratat e interesave privatë vjetorë. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk provoi ligjshmërinë e krijimit të burimeve financiare për likuidimin e këstit të tretë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.*
87. Referuar informacionit të përcjellë nga shoqëria “{***}” ShPK, protokolluar pranë Komisionit me nr. {***}, datë 06.08.2018, nga vlera totale e apartamentit prej 196.500 eurosh, është zbritur vlera 6.083 euro për punime të kryera nga vetë porositësi. Lidhur me këtë vlerë, subjekti i rivlerësimit pretendon se *nuk ka nënshkruar një amendim të kontratës për shkak se shuma prej 6.083 eurosh do të zbritet nga vlera totale e mbetur prej 196.500 eurosh, në momentin kur shoqëria “{***}”*

*ShPK do të mund të regjistrojë banesën, dhe se nuk ka detyrim ligjor për të depozituar faturat e punimeve pasi asnjëra prej tyre nuk tejkalon shumën e kërkuar me ligj për t'u deklaruar. Nga analizimi i shkresës së përcjellë Komisionit nga shoqëria “{***}” ShPK, si dhe përgjigjet e datës 18.01.2019, dhënë nga subjekti pyetësorit të Komisionit, detyrimi i mbetur pashlyer si këst i fundit ndaj shoqërisë deri në hipotekimin e apartamentit dhe garazhit, është në vlerën 19650 euro, që përbën 10% të çmimit total prej 196500 eurosh. Trupi gjykues konstaton se sa më sipër bie në kundërshtim me pretendimin e ngritur nga subjekti në ankim, se nga detyrimi prej 19650 eurosh do të zbritet shuma prej 6083 eurosh. Sipas përlllogaritjeve të kryera bazuar në dokumentacionin justifikues ligjor të përcjellë nga shoqëria “{***}” ShPK, detyrimi i mbetur i subjektit ndaj shoqërisë rezulton në vlerën 18191 euro (196500 euro – 172226 euro deklaruar nga shoqëria si të shlyera – 6083 euro deklaruar të zbritura = 18191 euro) dhe jo 19650 euro sa deklaroi subjekti i rivlerësimit (196500 euro – 170767 euro – 6083 euro), në mospërputhje me pretendimin në ankim sipas të cilit detyrimi do të rezultonte në vlerën 13567 euro (19650 – 6083 euro). Bazuar në sa arsyetuar më lart, trupi gjykues del në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë detyrimin e mbetur ndaj shoqërisë “{***}” ShPK, si në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë, ashtu edhe në deklaratën e pasurisë *vetting*.*

Në përfundim, për këtë pasuri, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, sipas nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pagimin e këstit të parë, sipas nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë në lidhje me kohën e likuidimit të këstit të parë në vitin 2008, në vlerën 3.700.000 lekë, sipas nenit 33, pika 5 germa “ç” e ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit nuk provoi ligjshmërinë e krijimit të burimeve financiare për likuidimin e këstit të tretë sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

88. Arsyetimi i mësipërm për vlerësimin e kësaj pasurie u bazua në aktet si më poshtë.
- i. Deklarata *vetting* 2017 dhe dokumentacioni bashkëlidhur, dorëzuar në ILDKPKI më datë 26.01.2017.
 - ii. Deklarata e interesave privatë, periodikë e viteve 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2014, 2015, 2016.
 - iii. Kontratë sipërmarrjeje, datë 14.02.2009, e nënshkruar mes shoqërisë “{***}” ShPK dhe znj. M. Ç.
 - iv. Shkresë nr. {***} prot., datë 21.06.2018, e ZVRPP Tiranë, dhe dokumentacioni bashkëlidhur.
 - v. Dokumentacioni i administruar nga shoqëria “{***}” ShPK, më datë 06.08.2018 (nr. {***} prot., datë 6.08.2018).
 - vi. Shkresa nr. {***} prot., datë 03.08.2018, e ZVRPP Durrës dhe dokumentacioni shoqëruar.
 - vii. Akt i Marrjes së Tokës në Pronësi nr. {***}, datë 09.09.1993.
 - viii. Akt i Marrjes së Tokës në Pronësi nr. {***}, datë 22.09.1999 dhe nr. 556, datë 2.2.1999.
 - ix. Kontratë për sipërmarrje dhe investime ndërtimore nr. {***} rep., nr. {***} kol, datë 21.01.2009, dhe kontratë aneks nr. {***} rep., nr. {***} kol, datë 14.11.2009.
 - x. Kontratë për shkëmbimin e pasurive të paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.12.2012, M. Ç. përfiton me shkëmbim nga shoqëria “{***}” ShPK.
 - xi. Kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme nr. {***} rep., {***} kol., datë 25.03.2002, 600 m² tokë ullishte, me shitës M. Ç. dhe Petrit Çeno dhe blerës B. D. (nr. pasurie 578/173).
 - xii. Aktmarrëveshje e datës 06.06.2007, e nënshkruar mes shoqërisë “{***}” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit dhe znj. M. Ç.

- xiii. Vërtetim i shoqërisë “{***}” ShPK nr. {***} prot., datë 15.01.2019.
- xiv. Kontratë shitjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.01.2012, e nënshkruar mes Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe znj. M. Ç.
- xv. Kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme nr. {***} rep., {***} kol., datë 18.11.2014, me palë shitëse M. Ç. dhe palë blerëse E. K. dhe K. K., në vlerën 95000 euro.
- xvi. Shkresë nr. {***} prot., datë 12.02.2018, e ZVRPP Kavajë, informacion në lidhje me pasuritë e paluajtshme të z. Petrit Çeno dhe familjarëve të tij.
- xvii. Shkresë nr. {***} prot., datë 01.08.2018, e ALUIZNI-t, së bashku me dosjen e praktikës së legalizimit në emër të znj. M. Ç.
- xviii. Dokumentacioni i depozituar nga subjekti gjatë pyetësorit dhe në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ.

89. Për kredinë në shumën 80.000 euro, marrë nga banka “Societe Generale Albania”.

90. Komisioni për këtë kredi ka vendosur që subjekti dhe personat e lidhur: i) kanë kryer deklaram të rremë ndaj bankës “Societe Generale Albania”, në lidhje me destinacionin e përdorimit të kredisë; ii) kanë mungesë dokumentacioni ligjor justifikues për të vërtetuar likuidimin e kësteve të kredisë nga shoqëria “{***}” ShPK, si përfutuese indirekte e kredisë; iii) subjekti ka kryer deklaram të rremë në deklaratën e vitit 2012 për kredinë e marrë pranë “Societe Generale Albania” për strehim, pasi është fshehur apartamenti që do përfitohej, po ashtu edhe revokimi i kontratës për apartamentin, si dhe kalimi i kredisë në favor të shoqërisë “{***}” ShPK; iv) subjekti ka fshehur dhe kryer deklaram të rremë në deklaratën e vitit 2013 për shlyerjet e kredisë pranë “Societe Generale Albania”, pasi nga dokumentet rezulton se kredia ka kaluar që në vitin 2012 në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, por nuk është shlyer; v) subjekti i rivlerësimit ka fshehur në deklaratën “vetting” të vitit 2017, faktin që është akoma bashkëkredimarrës në këtë kredi.

91. Referuar deklaratave të interesave privatë periodikë dhe deklaratës së pasurisë vetting 2017, trupi gjykues konstaton, si vijon:

- Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit deklaroi detyrimin financiar: Kredi e marrë te Banka “Societe Generale Albania” për strehim, e marrë më datë 14.12.2012, në vlerën 80.000 euro për një afat 20-vjeçar. Paga e kështit të parë fillon në janar 2013.
- Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2013, subjekti i rivlerësimit deklaroi: Kredi e marrë te Banka “Societe Generale Albania” në shumën 80.000 euro. Shuma e shlyer në vitin 2013, 7.000 euro.
- Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2014, personi i lidhur E. Ç., në rubrikën “Ndryshim i pasurive dhe burimi i krijimit”, deklaroi: Kredia bankare e marrë te banka “Societe Generale” në vitin 2013 në shumën prej 80.000 eurosh i ka kaluar për llogari të kompanisë së Shoqërisë “{***}” dhe shlyerja e kësaj kredie të bëhet nga kjo kompani si pjesë e biznesit të saj.
- Në deklaratën e interesave privatë të viteve 2015 dhe 2016, subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë deklaruar detyrimin financiar, kredinë e marrë në Bankën “Societe Generale Albania”.
- Në deklaratën e pasurisë vetting 2017, në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, personi i lidhur, E. Ç., deklaroi: Për llogari të shoqërisë në përqindjen e mbajtur nga unë (33,00% në shoqërinë “{***}” ShPK) jam financuar me një kredi hipotekare me nr. 29524, me shumë euro 80.000, pranë Bankës “Societe Generale Albania”, për të cilën prindërit e mi, Petrit dhe M. Ç., kanë dalë garant për këtë kredi duke vënë në dispozicion të

bankës pasuritë me nr. {***}, zona kadastrale nr. {***}, volumi {***}, faqe {***}, {***} Durrës; pasuria me nr. {***}, zona kadastrale {***}, volumi {***}, faqe {***}, {***} Durrës; pasuria me nr. {***}, zona kadastrale {***}, volumi {***}, faqe {***}, {***} Durrës. Kredia e mbetur e pashlyer në vlerën 71291 euro.

92. Me kontratën për prenotim apartamenti nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.11.2012, personi i lidhur/djali i subjektit, E. Ç., në cilësinë e palës porositëse dhe shoqëria “{***}” ShPK, si palë sipërmarrëse, nënshkruajnë kontratë për prenotimin e një apartamenti me sipërfaqe 220 m², apartamenti nr. 6, kati i parë i godinë shërbimi dhe banimi 7 kate + 1 kat parkim nën tokë, të ndërtuar mbi truallin 2775 m² në emër të znj. M. Ç. dhe 975 m² në emër të z. A. D.. Sipas kontratës për prenotim apartamenti, vlera e tij është përcaktuar 85.000 euro, nga të cilat kësti i parë prej 5.000 eurosh është paguar para noterit me nënshkrimin e kontratës më datë 13.11.2012 dhe kësti i dytë prej 80.000 eurosh do të paguhet brenda datës 30.01.2013, pas miratimit dhe akordimit të kredisë bankare, duke u dokumentuar pagesa me transfertë bankare. Pala sipërmarrëse garanton palën porositëse se apartamenti me sipërfaqe 220 m², objekt kontrate, nuk është parashikuar për t’u përfutur me shkëmbim nga pronarët e truallit, M. Ç. dhe A. D., si dhe nuk është objekt i marrëdhënieve juridike civile të porosisë me të tretët. Si përcaktuar specifikisht në kontratë, afati i përfundimit të godinës është përcaktuar data 30.12.2012.
93. Më datë 14.12.2012 nënshkruhet kontratë kredie bankare afatgjatë për shtëpi nr. {***}, datë 14.12.2012 (nr. {***} rep., nr. {***} kol.), mes kredidhënësit Banka “Societe Generale Albania” dhe kredimarrësve Petrit Çeno, M. Ç. dhe E. Ç.. Kjo kredi, sipas përcaktimit në kontratë, do të përdoret nga kredimarrësi për blerje apartamenti.
94. Për efekt garancie në kthimin e kredisë së dhënë nga Banka “Societe Generale Albania”, me anë të kontratës së hipotekimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.12.2012, vendoset hipotekimi i 3 pasurive të paluajtshme në pronësi të hipotekuesit M. Ç., më konkretisht: i) apartamentit me sipërfaqe 96,16 m² me nr. pasurie {***}; ii) apartamentit me sipërfaqe 111,56 m², nr. pasurie {***}; iii) njësisë me sipërfaqe 68 m², me nr. pasurie {***}, të ndodhura në zonën kadastrale {***}, {***} Durrës.
95. Në vijim të kërkesës së Komisionit nr. {***} prot., datë 08.03.2018, drejtuar Bankës së Shqipërisë dhe bankave të nivelit të dytë, për informacion mbi çdo veprimtari bankare dhe financiare, si: depozitë, kredi *overdraft*, garanci, kartë debiti/kredi, çek, transfert/urdhërshirime me jashtë/brenda vendit, Banka “Societe Generale Albania” me shkresën nr. {***}, datë 23.03.2018, ndër të tjera konfirmon së pranë kësaj banke rezulton kredi trevërore, Petrit Çeno, M. Ç. dhe E. Ç., me këste dhe me detyrim të papaguar deri më datë 23.03.2018, në vlerën 67463,6 euro.
96. Referuar dokumentit “Historik lëvizje nga 14.12.2012 te 21.03.2018” të llogarive bankare, përcjellë Komisionit nga Banka “Societe Generale Albania”, rezulton që kredia është disbursuar më datë 20.12.2012 në favor të shoqërisë “{***}” ShPK. Kontrata për prenotimin e apartamentit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.11.2012, e lidhur mes E. Ç. dhe shoqërisë “{***}” ShPK, revokohet më datë 21.12.2012, me anë të deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., pra një ditë pas disbursimit të kredisë. Sipas deklaratës noteriale, kërkesa për revokimin e kontratës është paraqitur nga E. Ç. dhe është pranuar nga pala sipërmarrëse, shoqëria “{***}” ShPK. Pala sipërmarrëse ka pranuar t’i kthejë mbrapsht shumën 85.000 euro, ndërkohë që rezulton që me transfertë bankare të jetë kthyer vlera 79.734 euro.

97. Subjekti i rivlerësimit në ankim pretendon se *kredia personale e tërhequr nga ortaku E. Ç. pranë Bankës “Societe Generale Albania” ka kaluar në favor të shoqërisë “{***}” ShPK ose “{***}” ShPK dhe se në datë 28.12.2012, vlera prej 79.734 eurosh kalon te Raiffeisen Bank, si pasojë e revokimit të kontratës së blerjes së një apartamenti me shoqërinë “{***}” ShPK Durrës (revokim kontrate nr. {***} rep., {***} kol.) Kjo shumë është përdorur për kapital qarkullues për shoqërinë në atë periudhë. Kryesisht kjo shumë është përdorur për të blerë karburant, material ndërtimi, pajisje e vegla pune për të ngritur rishtazi kantierin e punës. Trupi gjykues konstaton se, referuar kontratës së kredisë bankare, nuk rezulton që kredia të jetë personale e z. E. Ç., por është një kredi me 3 kredimarrës, Petrit Çeno, M. Ç. dhe E. Ç.. Në kushtet kur pretendohet kalimi i kredisë në favor të shoqërisë, kjo nënkupton një marrëdhënie juridike që ka të bëjë me zëvendësim të debitorit dhe kjo mund të kryhet vetëm me pëlqim të kreditorit, sipas përcaktimeve të nenit 496 të Kodit Civil¹¹ të Republikës së Shqipërisë. Referuar përcaktimeve të nenit 498 të këtij kodi, *marrëveshja sipas së cilës debitori dhe një person i tretë bëhen bashkëdebitorë në një detyrim, kur është dhënë pëlqimi i kreditorit, nuk mund të prishet apo të ndryshohet pa pëlqimin e kreditorit. Të dy bashkëdebitorët përgjigjen ndaj tij (kreditorit) solidarisht.* Bazuar në sa më sipër, kredia nuk mund t’i transferohej shoqërisë pa pëlqimin e kreditorit, për më tepër kur referuar nenit 501 të Kodit Civil, *kalimi i kredisë duhet të bëhet me shkresë, ndryshe nuk është i vlefshëm.* Në rastin konkret, nuk rezulton asnjë dokument i lëshuar nga Banka “Societe Generale Albania” që jep miratimin për transferimin e kredisë në emër të shoqërisë “{***}” ShPK. Sipas shkresës nr. {***}, datë 23.03.2018, të Bankës “Societe Generale Albania”, për këtë bankë, kredimarrës vazhdojnë të jenë subjekti i rivlerësimit dhe dy personat e lidhur me të. Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.*
98. Subjekti pretendon në ankim se *kjo kredi është paraqitur në pasqyrat financiare të vitit 2012 të shoqërisë, në zërin “Detyrime të tjera afatshkurtra”, të pasivit të bilancit, më konkretisht në shumën prej 15.784.264 lekësh, nga të cilat 11.162.760 lekë ishin arkëtimit nga revokimi i kontratës së blerjes së një apartamenti me shoqërinë “{***}” ShPK, i kredisë personale të tërhequr nga ortaku E. Ç. pranë SGA Bank. Pjesa tjetër prej 4.621.504 lekësh ishte kontribut ortaku tjetër i shoqërisë në atë kohë, E. M.. Nga momenti që kjo shumë ka kaluar në llogarinë e shoqërisë “{***}” ShPK, këstet e kredisë janë paguar nga shoqëria, kryesisht cash.* Trupi gjykues lidhur me pretendimin sa më sipër, vlerëson se nuk është provuar me dokumentacion justifikues ligjor nga subjekti i rivlerësimit veprimi i kalimit të kredisë në llogari të shoqërisë “{***}” ShPK dhe se debitorë *de jure* të kësaj kredie janë subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur. Sa më sipër, pretendimi i subjektit është i pabazuar.
99. Trupi gjykues konstaton gjithashtu se në kontratën për kredi bankare afatgjatë për shtëpi nr. {***}, datë 14.12.2012, paragrafi B, “Kushtet e lëvrimit dhe të shlyerjes”, pika 8, germa “g” parashikon: *8. Kredimarrësi ose/dhe dorëzanësi i deklaron dhe garanton bankën (e cila bazuar në deklarime dhe garanci të tilla ka marrë vendimin për dhënien e kredisë), sa më poshtë: [...] g) kredimarrësi do të përdorë shumën e kredisë vetëm sipas qëllimit të përcaktuar në këtë kontratë.* Nëse banka konstaton se nuk është realizuar qëllimi i dhënies së kredisë nga kredimarrësi, pra ky i fundit nuk e shfrytëzon kredinë e marrë sipas objektit të parashikuar, banka ka të drejtë ta deklarojë të zgjidhur këtë kontratë duke kërkuar kthimin e kredisë (germa “b” dhe paragrafi 2 i pikës 10 të kontratës).

¹¹Neni 496 i Kodit Civil: “Zëvendësimi i debitorit me një person tjetër, i cili merr përsipër detyrimin, mund të bëhet vetëm me pëlqimin e kreditorit. Debitori i zëvendësuar shkarkohet nga detyrimi i tij ndaj kreditorit. Garancitë e dhëna nga persona të tretë për detyrimin shuhen, në rast se këta nuk kanë dhënë pëlqimin që ato të mbeten edhe për debitorin e ri. Pengu ose hipoteka e dhënë nga debitori i mëparshëm mbeten në fuqi”.

100. Mbështetur në analizën e mësipërme, duke qenë se nuk ka një dokument ligjor që të provojë kalimin e kredisë të shoqëria “{***}” ShPK, si kontratë, kërkesë nga debitorët, miratim nga kredidhënësi, apo vendim asambleje nga shoqëria, nisur nga fakti që kontrata “Kredi bankare afatgjatë për shtëpi” nr. {***}, datë 14.12.2012, nuk ka ndryshuar, është në fuqi dhe vijon të sjellë pasoja juridike për palët, trupi gjykues çmon se, në zbatim të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe nenit 31, pika 1 dhe shtojca nr. 2 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur detyrimin të deklarojnë këtë detyrim financiar ndaj palëve të treta në deklaratën e interesave privatë të vitit 2014 e në vazhdim, si dhe në deklaratën e pasurisë *vetting* 2017.

101. Nisur nga fakti që kontrata për prenotimin e apartamentit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.11.2012, e lidhur mes z. E. Ç. dhe shoqërisë “{***}” ShPK, revokohet më datë 21.12.2012 me anë të deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., pra një ditë pas disbursimit të kredisë, fakti që shumta e revokuar prej 79.734 eurosh është transferuar nga shoqëria “{***}” ShPK në llogarinë bankare të shoqërisë “{***}” ShPK në Raiffesen Bank, më 28.12.2012, dhe është përdorur për kapital qarkullues për shoqërinë në atë periudhë, ndërkohë që vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë të vitit 2013 deklaroi shumën e shlyer për kredinë hipotekare në vlerën 7.000 euro, në kushtet kur *de facto* i kishte kaluar shoqërisë që në dhjetor 2012, të krijojnë bindjen që subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë dashur të përfitojnë financim me kushte të favorshme nisur nga kriteret e kredisë për strehim, si interes i ulët (6%, LIBOR 12M Eur + 4%, por jo më pak se 6% në vit), afat më i gjatë maturimi (20 vjet) kundrejt interesave të larta dhe afatit të shkurtër të maturimit të kredisë për biznes (deri në 10 vjet).

Në përfundim, për kredinë në shumën 80.000 euro, marrë nga Banka “Societe Generale Albania”, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, me anë të veprimeve dhe mosveprimeve të tij, ka cenuar besimin e publikut, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi kredia e marrë për strehim është përdorur nga shoqëria “{}” ShPK.***

102. Arsytimi i mësipërm u bazua në aktet si më poshtë.

- i. Deklarata e pasurisë “*vetting*” dhe dokumentacioni i dorëzuar në ILDKPKI.
- ii. Deklarata e interesave privatë vjetore e viteve 2012 deri 2016.
- iii. Kontratë për prenotim apartamenti nr. {***} rep., nr. {***} kol, datë 13.11.2012, ndërmjet z. E. Ç. dhe shoqërisë “{***}” ShPK.
- iv. Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.12.2012, për revokimin e kontratës së prenotimit të apartamentit mes palës sipërmarrëse, firmës ndërtimore “{***}” ShPK, dhe palës porositëse, z.E. Ç..
- v. Kontratë kredi bankare afatgjatë për shtëpi nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.12.2012, mes Bankës “Societe Generale Albania” dhe kredimarrësve E. Ç., M. Ç. dhe Petrit Çeno.
- vi. Kontratë hipotekimi nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.12.2012, ku vendoset hipotekimi i 3 pasurive të paluajtshme në pronësi të hipotekueses M. Ç..
- vii. Shkresa e Bankës “Societe Generale Albania” nr. {***}, datë 23.03.2018.
- viii. Shkresë e administruar nga shoqëria “{***}” ShPK, dërguar ILDKPKI-së (protokolluar me nr. {***} prot., datë 22.12.2017).
- ix. Shkresa nr. {***} prot., datë 10.04.2018, e Qendrës Kombëtare e Biznesit.

103. Mbi të drejtën e pronësisë në aksione të personit të lidhur, z. E. Ç..

104. Komisioni, për këto pasuri, ka konkluduar se: i) Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë në lidhje me personin e lidhur, z. E. Ç., në deklaratat ndër vite pranë ILDKPKI-së, në lidhje me pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërisë “{***}” ShPK; ka deklaruar blerjen e 50% të kapitalit në vitin 2011, në fakt blerja është bërë në vitin 2010. Në vitin 2012, ka shitur 5% të kuotave, ndërsa në vitin 2015 ka shitur edhe 12% të tyre. ii) Ka fshehur në deklaratën “vetting” të vitit 2017, aksionet e personit të lidhur, z. E. Ç., në shoqëritë “{***}” ShPK; “{***}” ShPK; “{***}” ShPK; “{***}” ShPK; “{***}” ShPK. iii) Ka fshehur në deklaramet vjetore, aksionet në shoqëritë e lartpërmendura.
105. Nga shqyrtimi i akteve të dosjes gjyqësore, trupi gjykues i Kolegjit vëren se Komisioni, në zbatim të nenit 50 të ligjit nr. 84/2016, ka kërkuar informacion pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), lidhur me të dhënat e administruara në Regjistrin Tregtar dhe në Regjistrin e Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve në lidhje me personin e lidhur, z. E. Ç.. QKB, me shkresën nr. {***} prot., datë 10.04.2018, vë në dispozicion të Komisionit ekstraktin historik të regjistrit tregtar, për secilën nga shoqëritë tregtare në të cilat rezulton personi i lidhur, z. E. Ç., në cilësinë e administratorit dhe/ose të ortakut.
106. Në lidhje me shoqërinë “{***}” ShPK, që më pas u bë shoqëria “{***}” ShPK, referuar ekstraktit historik të përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 10.04.2018, të Qendrës Kombëtare të Biznesit, dhe deklaratave të interesave privatë ndër vite, rezulton:
- Subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë të vitit 2011 ka deklaruar: *Djali E. Ç. është b/pronar në shoq. “{***}”, me leje studimi minerale me kap. fillestar 100000 lekë. Në vlerën 50000 lekë, ndërkohë që këto aksione duhet të ishin deklaruar në vitin 2010, pasi E. Ç. është shtuar si ortak me vendimin e ortakut të vetëm të shoqërisë “{***}” ShPK, datë 20.03.2010, të regjistruar në QKB, më 23.03.2010.*
 - Subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë të vitit 2013, nuk ka deklaruar zvogëlimin e kuotave nga 50% në 45% pranë kësaj shoqërie.
 - Subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë të vitit 2015 nuk ka deklaruar zvogëlimin e kuotave nga 45% në 33% pranë kësaj shoqërie.
 - Në deklaratën e pasurisë *vetting* 2017, personi i lidhur E. Ç. deklaron të jetë “Bashkaksioner në shoqërinë “{***}” ShPK, në vlerën 33,00%”.
107. Subjekti në ankim pretendon se, nëse do t’i referohemi ligjit të kohës nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar, si dhe formularëve të hartuar për çdo vit nga ILDKPKI-ja, në asnjë nga kërkesat për deklaram nuk përmenden ndryshime dhe deklarime kaq të detajuara, ku të përfshiheshin ndryshimet që bëheshin dhe zhbëheshin brenda vitit. Trupi gjykues, lidhur me këtë pretendim, vlerëson se bazuar në nenin 7, pika 1 e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, në deklaramin periodik jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat privatë të deklaruar më parë, si dhe ata të lindur gjatë vitit që deklarohet, si dhe çdo e ardhur e fituar dhe shpenzim i deklarueshëm i bërë gjatë atij viti për të cilin deklarohet, personi i lidhur në respektim dhe të nenit 4, germa “ç” e ligjit nr. 9049, ka pasur detyrimin të deklarojë gjendjen deri më datë 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, përfshirë vlerën e aksioneve dhe pjesëve të kapitalit në zotërim dhe burimin e krijimit të tyre.
108. Trupi gjykues i Kolegjit, mbështetur në të dhënat e ekstraktit historik të shoqërisë “{***}” ShPK, e cila më datë 24.07.2017 ndryshoi emrin tregtar në “{***}” ShPK, si dhe mbështetur në të dhënat e ekstraktit historik të kësaj të fundit, mban qëndrim ndryshe nga ai i Komisionit mbi deklaramin

e pronësisë mbi këto kuota. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se nuk ndodhemi në kushtet e deklaramit të rremë, pasi në deklaratën e pasurisë *vetting* 2017, personi i lidhur E. Ç. ka deklaruar 33% të aksioneve pranë kësaj shoqërie, sipas të dhënave të ekstraktit historik. Po kështu, trupi gjykues vlerëson se nuk ndodhemi para faktit të fshehjes së kuotave të kapitalit pranë shoqërisë “{***}” ShPK, pasi kjo shoqëri ka marrë këtë emër më datë 24.07.2017 dhe në kohën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë *vetting* 2017, ka pasur emrin shoqëria “{***}” ShPK dhe kuota pranë kësaj shoqërie janë deklaruar nga personi i lidhur në deklaratën e pasurisë *vetting*.

109. *Në lidhje me shoqërinë “{***}” ShPK*, nga të dhënat e ekstraktit historik, rezulton se shoqëria “{***}” ShPK është regjistruar më datë 05.10.2010. Personi i lidhur E. Ç. rezulton ortak i kësaj shoqërie me 50% të kapitalit dhe, më datë 06.08.2012, është emëruar administrator i saj. Më datë 24.11.2014, kjo shoqëri kaloi në statusin e pezulluar.

Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* kuotat e personit të lidhur E. Ç. pranë kësaj shoqërie. Subjekti në ankim pretendon se kjo shoqëri nuk ka kryer aktivitet në asnjë moment, nuk ka realizuar të ardhura, është pezulluar dhe është një shoqëri në likuidim. Trupi gjykues vlerëson se ky fakt nuk e shkarkon subjektin nga detyrimi për të deklaruar kuotat e kapitalit pranë saj, për sa kohë shoqëria rezulton e regjistruar.

Në kuptim të nenit 31, pika 1 dhe të shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016, si dhe bazuar në pikën 7 të udhëzimit¹² të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur duhet të deklaronte në deklaratën e pasurisë *vetting* 2017, vlerën e aksioneve dhe pjesët e kapitalit në zotërim në këtë shoqëri tregtare, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit në momentin e fitimit të tyre.

110. *Në lidhje me shoqërinë “{***}” ShPK*, nga të dhënat e ekstraktit historik, rezulton se kjo shoqëri është regjistruar më 25.02.2009. E. Ç. është bashkortak me 33% të vlerës së kapitalit. Kjo shoqëri rezulton me status aktiv.

Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* kuotat e personit të lidhur E. Ç. pranë kësaj shoqërie.

Subjekti në ankim pretendon se ka të paktën 2 vjet që kjo shoqëri ka kaluar me status pasiv në tatime, për arsye se që në fillim nuk ka zhvilluar aktivitet dhe të ardhurat e gjeneruara nga kjo shoqëri që nga dita e parë e krijimit janë 0 lekë. Trupi gjykues, lidhur me këtë pretendim, vlerëson se ky fakt përsëri nuk e shkarkon subjektin nga detyrimi për të deklaruar kuotat e kapitalit pranë kësaj shoqërie dhe, bazuar në pikën 7 të udhëzimit të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur duhet të deklaronte në deklaratën e pasurisë *vetting* 2017, vlerën e aksioneve në zotërim në këtë shoqëri tregtare, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit në momentin e fitimit të tyre.

111. *Në lidhje me shoqërinë “{***}” ShPK*, nga të dhënat e ekstraktit historik, rezulton se kjo shoqëri është regjistruar më 18.09.2009 dhe 80% e kuotave të kapitalit zotëroreshin nga E. Ç.. Më datë 29.12.2010, kjo shoqëri kalon në statusin “shoqëri në likuidim e sipër”.

¹²Udhëzim nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklaramit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* kuotat e personit të lidhur E. Ç. pranë kësaj shoqërie.

Në kuptim të nenit 31, pika 1 dhe të shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016, si dhe bazuar në pikën 7 të udhëzimit të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur duhet të deklaronte në deklaratën e pasurisë *vetting* 2017, vlerën e aksioneve dhe pjesët e kapitalit në zotërim në këtë shoqëri tregtare, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit në momentin e fitimit të tyre.

112. *Në lidhje me shoqërinë “{***}” ShPK, nga të dhënat e ekstraktit historik, kjo shoqëri është regjistruar më 02.10.2012 dhe 50% të kuotave të kapitalit të kësaj shoqërie zotërohen nga shoqëria “{***}” ShPK.*

Personi i lidhur E. Ç., si ortak dhe administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, nuk ka deklaruar në deklaratën e interesave privatë të vitit 2012, 50% të kuotave të kapitalit të shoqërisë “{***}” ShPK. Personi i lidhur E. Ç. nuk ka deklaruar në deklaratën e interesave privatë të vitit 2013, emërimin si administrator pranë kësaj shoqërie.

113. *Trupi gjykues i Kolegjit, ndryshe nga qëndrimi i mbajtur nga Komisioni në vendim, se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të kuotave të kapitalit për shoqërinë “{***}” ShPK, vlerëson se nuk ndodhemi në kushtet e fshehjes së kuotave të kapitalit, pasi personi i lidhur ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* 2017, kuotat e kapitalit pranë shoqërisë “{***}” ShPK, dhe është pikërisht shoqëria “{***}” ShPK që zotëron 50% të kapitalit të shoqërisë “{***}” ShPK.*

114. *Në lidhje me shoqërinë “{***}” ShPK, nga të dhënat e ekstraktit historik, kjo shoqëri është themeluar më datë 26.01.2017 dhe është regjistruar më 01.02.2017. Personat e lidhur, znj.G. Ç. dhe E. Ç., zotërojnë respektivisht nga 33% të kuotave të kësaj shoqërie. Komisioni ka dalë në konkluzion në vendim se subjekti i rivlerësimit ka fshehur në deklaratën e pasurisë *vetting* të vitit 2017, aksionet e personit të lidhur E. Ç. pranë kësaj shoqërie. Referuar ekstraktit historik, rezulton se shoqëria është themeluar në të njëjtën datë me dorëzimin e deklaratës së pasurisë *vetting* më 26.01.2017, por është regjistruar në QKB më datë 01.02.2017, trupi gjykues vlerëson se deklarimi i pjesëve të kapitalit për këtë shoqëri duhet të bëhet në deklaratën e interesave privatë të vitit 2017.*

*Në përfundim, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka fshehur në deklaratën e pasurisë *vetting* të vitit 2017, të drejtën e pronësisë mbi aksionet e personit të lidhur E. Ç. në shoqëritë: “{***}” ShPK; “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK, sipas përcaktimit të nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.*

115. *Arsyetimi i mësipërm u bazua në aktet si më poshtë.*

- i. Deklarata e pasurisë *vetting* e vitit 2017 dhe dokumentacioni i dorëzuar në ILDKPKI.
- ii. Deklarata e interesave privatë e viteve 2010, 2011, 2012 dhe 2013.
- iii. Shkresa nr. {***} prot., datë 10.04.2018, e Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- iv. Ekstraktet historike të shoqërive “{***}” ShPK; “{***}” ShPK, “{***}” ShPK; “{***}” ShPK, “{***}” ShPK, “{***}” ShPK, “{***}” ShPK.

116. *Për pasurinë, automjeti tip “Renault Megane”.*

117. *Komisioni, për këtë pasuri, ka vendosur se subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklarim në lidhje me vlerën dhe mënyrën e pagesës së automjetit.*

118. Nga subjekti i rivlerësimit, kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në deklaratën e interesave privatë të vitit 2005: *Blerë autoveturë e markës “Renault Megan”, me targë {***}, në emër të bashkëshortes M. Ç., e blerë me kredi, plus shumën e shitjes së makinës “Benz” dhe një pjesë me kursimet vjetore. Në vlerën 18000 euro.*
- Në deklaratën e pasurisë *vetting*, bashkëshortja e subjektit deklaron: *Blerja e një makine nga {***}, tipi Renault Megane, në vlerën 18500 euro, paguar pjesërisht nga një kredi e marrë nga Banka Tirana, në vitin 2005 (10000 euro) dhe pjesërisht nga kursimet e familjes.*
- Në kontratën e shitjes së datës 15.08.2005, të nënshkruar ndërmjet Auto Service “{***}” ShPK dhe znj. M. Ç., e cila nuk është nënshkruar para noterit: *Çmimi i shitjes së automjetit është euro 18490 [...] Çmimi i shitjes së automjetit në euro është çmimi reference. Në këtë kontratë, po kështu citohet: Shënime: Paradhënia e paguar datë 15.08.05 është 7000 € (shtatë mijë euro). Pagesa përfundimtare, datë 29.10.2005, është 11500 (njëmbëdhjetë mijë e pesëqind) euro. Mandat nr. {***}.*
119. Nga shqyrtimi i akteve më sipër, trupi gjykues konstaton se ka mospërputhje në deklaratimet e subjektit në lidhje me vlerën e automjetit, pasi në vitin 2005 deklaron se vlera është 18000 euro, në deklaratën e pasurisë *vetting* të vitit 2017 deklaron se vlera është 18500 euro, ndërsa në faturën tatimore të shitjes të lëshuar nga shoqëria distributore Auto Service “{***}” ShPK, përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor me shkresën nr. {***} prot., datë 22.02.2018, vlera e blerjes është 2220000 lekë.
120. *Lidhur me pretendimin e subjektit në ankim se fatura tatimore është vendosur në monedhën vendase në lekë dhe jo euro, pra nëse do të konvertoheshin 18500 euro me kursin e kohës, do të bëhet 2220000 lekë,* trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se nuk qëndron pasi, nëse i referohemi kursit të këmbimit valutor të Bankës së Shqipërisë, ditën kur është lëshuar fatura tatimore nga shoqëria {***} ShPK, vlera e sipërcituar në lekë konvertohet në 18070 euro (kursi i datës 23.11.2005, 1 euro = 122,85 lekë). Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron.
121. Lidhur me kohën e kryerjes së pagesës së vlerës së automjetit, subjekti në përgjigje të pyetësorit të Komisionit depoziton dy mandatarkëtime, mandatarkëtimin e datës 13.08.2005 për pagesën e vlerës 7000 euro dhe mandatarkëtimin nr. {***}, datë 29.10.2005, për pagesën 11500 euro, ndërsa fatura tatimore e shitjes e lëshuar nga “{***}” ShPK, si pjesë përbërëse e dosjes së mjetit në DPSHTRR, mban datën 23.11.2005.
122. Referuar sa deklaron personi i lidhur në deklaratën e pasurisë *vetting* se si burim krijimi për vlerën 11500 euro ka shërbyer kredia e marrë nga Tirana Bank, kjo bankë me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 12.02.2018, informon se shtetasi Petrit Çeno është financuar me kredi në shumën 10000 euro, të disbursuar më datë 01.09.2005, kredi e shlyer më datë 09.05.2007 (shlyerje e parakohshme). Në dokumentin financiar “Nxjerrje llogarie” bashkëlidhur kësaj shkrese, rezulton se kredia është disbursuar më datë 01.09.2005 dhe është tërhequr nga subjekti i rivlerësimit më datë 31.10.2005, dy ditë pasi ishte paguar kësti i dytë 11500 euro, sipas mandatarkëtimin nr. {***}, më datë 29.10.2005. Trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, pasi e ka deklaruar kredinë si burim krijimi, ndërkohë që kredia është tërhequr pas likuidimit të vlerës së automjetit.
123. Në lidhje me pretendimin e subjektit në ankim, mbi qëndrimin e Komisionit për mospërputhjen në lidhje me momentin e porosisë së automjetit dhe atë të mbërritjes në portin e Durrësit, trupi gjykues

konstaton se Komisioni është shprehur për këtë në paragrafët 9.13 dhe 9.14 të vendimit, prej ku citohet: *Në lidhje me kohën e blerjes së mjetit dhe mospërputhjeve që ekzistonin midis dokumentacionit të blerjes, subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm këto mospërputhje.*

Në lidhje me gjetjet e tjera gjatë hetimit, Komisioni arsyeton se këto mospërputhje kanë ardhur si rezultat i procedurës së ndjekur nga momenti i kontratës së porosisë deri në momentin e dorëzimit të makinës te personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim nuk mund të përbënte shkak ankimi ndaj vendimit të Komisionit.

Për këtë pasuri, automjet tip “Renault Megane”, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti ka deklaruar në mënyrë të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, duke cenuar besimin e publikut sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

124. Arsyetimi i mësipërm për vlerësimin e kësaj pasurie u bazua në aktet si më poshtë.

- i. Deklarata e pasurisë “vetting” dhe dokumentacioni i dorëzuar në ILDKPKI.
- ii. Deklarata e interesave privatë të vitit 2005.
- iii. Kontratë shitjeje e datës 15.08.2005, nënshkruar ndërmjet Auto Service “{***}” ShPK dhe znj. M. Ç..
- iv. Shkresë nr. {***} prot., datë 27.07.2018, e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, me të cilën konstatohet se në dosjen e mjetit me targë {***} në fillim dhe ndryshuar në {***} nuk ndodhet kontrata e shitblerjes së mjetit.
- v. Shkresë e Bankës “Tirana Bank” nr. {***} prot., datë 12.02.2018, sipas së cilës subjekti ka pasur kredi në shumën 10000 euro, disbursuar më datë 01.09.2005, kredia është shlyer më datë 09.05.2007.
- vi. Mandatarkëtimi i datës 13.08.2005 për pagesën e vlerës 7000 euro dhe mandatarkëtimi nr. {***}, datë 29.10.2005, për pagesën e vlerës 11500 euro.
- vii. Faturë tatimore shitjeje (nr. serisë {***}), datë 23.11.2005, nr. i faturës {***}.

125. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, shkaqet e ankimit dhe provat e administruara, arrin në përfundimin se:

i. *Për pasurinë apartament me sipërfaqe 98 m² dhe garazh me sipërfaqe 22 m², ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.*

ii. *Për pasurinë apartament me sipërfaqe 79 m², ndodhur në fshatin {***}, Komuna {***}, Kavajë, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë në lidhje me burimin e krijimit sipas nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, si dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, sipas nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.*

iii. *Për pasurinë apartament me sipërfaqe 144 m² dhe garazh me sipërfaqe 20 m², ndodhur në rr. “{***}”, pallati “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, sipas nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pagimin e këstit të parë, sipas nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të rremë në lidhje me kohën e likuidimit të këstit të parë në vitin 2008, në vlerën 3.700.000 lekë, sipas nenit 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit nuk provoi ligjshmërinë e krijimit të burimeve financiare për likuidimin e këstit të tretë sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.*

iv. Për kredinë në shumën 80.000 euro, marrë nga Banka “Societe Generale Albania”, subjekti i rivlerësimit, me anë të veprimeve dhe mosveprimeve të tij, ka cenuar besimin e publikut, pasi kredia e marrë për strehim është përdorur nga shoqëria “{***}” ShPK, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

v. Subjekti i rivlerësimit ka fshehur në deklaratën e pasurisë “vetting” të vitit 2017, të drejtën e pronësisë mbi aksionet e personit të lidhur E. Ç. në shoqëritë: “{***}” ShPK; “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK, sipas përcaktimit të nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

vi. Për pasurinë automjet tip “Renault Megane”, subjekti ka deklaruar në mënyrë të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, duke cenuar besimin e publikut sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

126. Në vlerësimin tërësor të procedurave për kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit, me anë të veprimeve dhe mosveprime të tij, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

127. Në përfundim, trupi gjyqësor i Kolegjit, bazuar në konkluzionet e mësipërme, në mbështetje të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, çmon se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 111, datë 27.02.2019, është i drejtë dhe duhet lënë në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupit gjyqësor i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, mbështetur në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 111, datë 27.02.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Petrit Çeno.
2. Ky vendim është përfundimtar, me efekt të menjëhershëm. U shpall sot, në Tiranë, më datë 09.07.2020.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTAR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Ne – gjyqtaret Natasha Mulaj, në cilësinë e relatores së çështjes, dhe Rezarta Schuetz, në cilësinë e kryesueses së trupit gjykues – jemi dakord me vendimin nr. 14, datë 09.07.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, nëpërmjet të cilit është vendosur unanimisht lënia në fuqi e vendimit nr. 111, datë 27.02.2019, e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), që i përket subjektit të rivlerësimit Petrit Çeno, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit, Durrës.
2. Mendimi ynë paralel, arsyetimi ndryshe nga shumica e anëtarëve të trupit gjykues në një pjesë të vendimit të themelit, është si më poshtë:

Nuk jemi dakord me konkluzionin e paraqitur nga shumica e trupit gjykues, i cili për pasurinë apartament me sipërfaqe 98 m² dhe garazh me sipërfaqe 22 m², ndodhur në rr. {***}, Tiranë, ka konkluduar vetëm për mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", pa vendosur për deklarin e rremë në lidhje me të ardhurat që kanë shërbyer si burim financiar për blerjen e apartamentit dhe garazhit të sipërcituar. Nga analizimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe akteve shkresore në dosjen gjyqësore, ka rezultuar se:

1. Në deklaratën e pasurisë për herë të parë në vitin 2003, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *Banesë 2+1, me sipërfaqe ndërtimi 98 m², rr. {***}, nr. {***}, Tiranë. Është blerë nga shitja që kam bërë, të shtëpisë së privatizuar si banesë ish-shtetërore në qytetin e Durrësit.*
2. Në deklaratën e pasurisë “vetting”, sa i përket burimit të krijimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Pagesa e këtyre pasurive është bërë nga kursimet e të ardhurave familjare para vitit 1997, si dhe një pjesë e mbetur nga shitja e një banese në Durrës, e cila vërtetohet me kontratën e shitjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.07.2003.*

Në paragrafët 53 dhe 54 të vendimit nr. 14, datë 09.07.2020, shumica e trupit gjykues arsyeton:

53. [...] Trupi gjykues i Kolegjit, nga analizimi i akteve shkresore (kontratave respektive të shitjes), konstaton se:

- në nenin 4, pika 4.1 e kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., {***} kol., datë 14.04.2003, për apartamentin me sipërfaqe 98 m² dhe nenin 4, pika 4.1 e kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol, datë 16.04.2003, për garazhin me sipërfaqe 22 m², parashikohet se: *shitësi deklaroi të jetë likuiduar plotësisht jashtë zyrës së noterisë. Çmimi i shitjes i është paguar sipërmarrësit ndërtues, shoqërisë {***} ShPK para redaktimit të kësaj kontrate. Nisur nga sa përcaktojnë këto kontrata, çmimi i apartamentit dhe garazhit rezultojnë të jenë likuiduar përpara datave 14.04.2003 dhe 16.04.2003.*

- referuar kontratës së shitjes nr. {***} rep., {***} kol., datë 21.07.2003, të apartamentit me sipërfaqe 64,46 m² dhe shtesës me sipërfaqe 30 m², ndodhur në rr. {***}, Durrës, rezultoi që subjekti e ka shitur këtë apartament në muajin korrik 2003, ndërkohë që kontrata nr. {***} rep.,

*{***} kol., për blerjen e apartamentit dhe kontrata nr. {***} rep., nr. {***} kol., për blerjen e garazhit, në Tiranë, datojnë mbi 3 muaj më përpara, përkatësisht më datë 14.04.2003 dhe 16.04.2003.*

*54. Në mbështetje të këtyre fakteve, trupi gjykues arrin në konkluzionin se shitja e apartamentit dhe e shtesës në qytetin e Durrësit, më datë 21.07.2003, nuk mund të ketë shërbyer si burim krijimi për blerjen e apartamentit dhe garazhit, të ndodhur në rr. {***}, Tiranë më datë 14.04.2003 dhe 16.04.2003.*

3. Për sa më sipër, vlerësojmë se ndodhemi në kushtet e deklaramit të rremë të kryer nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë të vitit 2003 dhe në deklaratën e pasurisë *vetting* 2017, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016, pasi të ardhurat nga shitja e banesës në Durrës me kontratë shitjeje nr. {***} rep., {***} kol., datë 21.07.2003, në vlerën 5.600.000 lekë nuk mund të kenë shërbyer si burim krijimi për apartamentin dhe garazhin e ndodhur në rrugën {***}, Tiranë.
4. Për pasurinë, apartament banimi me sipërfaqe 79 m², të ndodhur në Kryemëdhënj, Kavajë, nuk jemi në dakordësi me konkluzionin e arritur nga shumica e trupit gjykues për të aplikuar vetëm nenin 33, pika 5, gerrat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016, që i referohen përkatësisht deklaramit të pasaktë në lidhje me burimin e krijimit dhe mungesës së burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie. Në vijim të arsytimit të shumicës në paragrafin 63 të vendimit nr. 14, datë 09.07.2020, se:

*63. [...] Trupi gjykues i Kolegjit vëren se në përmbajtje të kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.07.2003, në rubrikën “Çmimi i shitjes”, përcaktohet se kjo shumë është likuiduar plotësisht nga blerësi jashtë kësaj zyre noteriale, por nuk specifikohet saktësisht koha e shlyerjes së çmimit të apartamentit, e cila mbetet e papërcaktuar. Duke vlerësuar se jemi në të njëjtën situatë si për apartamentin me sipërfaqe 98 m² të ndodhur në rr. {***}, Tiranë, për të cilin po ashtu nga subjekti është pretenduar si burim krijimi të ardhurat nga shitja e apartamentit në qytetin e Durrësit, me të njëjtin arsyetim, trupi gjykues vlerëson se shitja e apartamentit në Durrës, më datë 21.07.2003, nuk mund të ketë shërbyer si burim krijimi për blerjen e apartamentit 79 m² në Kryemëdhënj, Kavajë, më datë 01.07.2003 – vlerësojmë se trupi gjykues i Kolegjit, përveç konkluzionit më sipër, duhet të arrinte edhe në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaramit të rremë sa i përket burimit të krijimit të pasurisë objekt shqyrtimi, pasi blerja e apartamentit në Kryemëdhënj është bërë përpara shitjes së apartamentit në qytetin e Durrësit. Ndodhur në këto kushte, duhet të ishte zbatuar sa parashikuar në nenin 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016.*

5. Në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës parashikohet: *[...] nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.* Në vijim, në shtojcën nr. 2 bashkëlidhur ligjit nr. 84/2016,

përcaktohet se mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i deklaratës së pasurisë mund të passjellë shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, sipas ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

6. Sipas dispozitave kushtetuese dhe ligjore më lart, jo çdo pasaktësi në deklaram të çon në marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, por në rastin konkret pasaktësitë në deklaramin e burimit të krijimit të pasurive të sipërcituara, passjellin mungesë të provueshmërisë së burimeve financiare të ligjshme dhe shmangie nga detyrimi për deklaram. Në përmbledhje të sa më sipër, shprehim mosdakordësinë me arsyetimin e shumicës së trupit gjykues për mosaplikim edhe të nenit 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016, deklaram i rremë i kryer nga subjekti i rivlerësimit për pasuritë e sipërmendura.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

GJYQTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Ne, gjyqtaret Ina Rama dhe Albana Shtylla, kemi votuar pro qëndrimit të mbajtur prej shumicës së trupit gjykues, për sa u përket të gjitha argumenteve të arsyetuara në vendim, të cilat legjitimojnë lënien në fuqi të vendimit nr. 111, datë 27.02.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Petrit Çeno, por jemi shprehur kundër qëndrimit të shumicës, për sa i përket konsiderimit si shkak shkarkimi për këtë subjekt rivlerësimi të cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”).
2. Ky qëndrim, ndonëse nuk afekton vendimmarrjen e Kolegjit, lidhet me një arsyetim të ndryshëm rreth zbatimit të dispozitës së mësipërme, në rastet kur subjektet e rivlerësimit janë vlerësuar vetëm mbi bazën e një kriteri rivlerësimi, arsyetim i mbajtur prej nesh edhe në çështje të tjera të ngjashme¹³.
3. Siç rezulton nga vendimi objekt shqyrtimi, subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit dhe është shkarkuar nga detyra, mbështetur në kontrollin dhe vlerësimin e vetëm një kriteri, që është ai i pasurisë. Brenda këtij kriteri, ashtu si Komisioni, edhe Kolegji ka gjetur një sërë shkeljesh nga ato që parashikon neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, të cilat e vendosin subjektin në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, situatë e cila shërben si bazë ligjore për të urdhëruar shkarkimin e subjektit nga detyra për deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë.
4. Përtej këtyre shkaqeve, me të cilat jemi dakordësuar plotësisht, shumica ka konkluduar se gjenden edhe dy shkelje të tjera të ligjit brenda kriterit të pasurisë të cilat, ndonëse nuk ngrihen prej shumicës në nivelin e një shkak shkarkimi brenda kriterit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, janë vlerësuar si të tilla në këndvështrim të vlerësimit të përgjithshëm, sipas parashikimeve të neneve 4, pika 2 dhe 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, duke u konsideruar se janë rrethana që e vendosin subjektin në kushtet e cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë sipas nenit 61, pika 5 e të njëjtit ligj.

Këto dy elemente, sipas vendimit të shumicës, lidhen me shkeljet e evidentuara në lidhje me:

- (i) kredinë në shumën 80.000 euro, marrë nga banka {***}, subjekti i rivlerësimit, me anë të veprimeve dhe mosveprimeve të tij, ka cenuar besimin e publikut, pasi kredia e marrë për strehim është përdorur nga shoqëria {***} ShPK, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
 - (ii) pasurinë automjet, tip “Renault Megane”, subjekti ka deklaruar në mënyrë të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, duke cenuar besimin e publikut, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
5. Duke qenë dakord me qëndrimin e shumicës se këto shkelje të subjektit të rivlerësimit përgjatë deklarimeve periodike të pasurisë së tij në vite, nuk përbëjnë shkelje të një natyre tillë që të ngrihen në nivelin e ndonjë shkak shkarkimi, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016,

¹³ Vendimi nr. 28/2019 (JR), datë 30.10.2019; vendimi nr. 34/2012 (JR), datë 02.12.2019; vendimi nr. 31/2019 (JR), datë 20.11.2019.

ne kemi vlerësuar se analizimi i tyre si shkaqe që mund të përbëjnë arsye për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, është në tejkalim të qëllimit të ligjvënësimit të pasqyruar në rregullin e parashikuar nga neni 61 pika 5 e ligjit nr. 84/2016 për arsyet e renditura më poshtë.

6. Sipas përcaktimit të neni 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave.

Ndërkohë neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 që përcakton cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë si një shkak autonom shkarkimi, parashikon se: *Në rast se nga vlerësimi tërësor, në kuptim të neni 4, pika 2 e këtij ligji, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.*

7. Cenimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë si shkak shkarkimi, në bazë të një interpretimi sistematik, konstatohet se është renditur si shkak i fundit i shkarkimit në dispozitën që parashikon të gjitha rastet e shkarkimit të subjekteve të rivlerësimit, pikërisht neni 61 i ligjit nr. 84/2016. Kjo dispozitë ka në përbërje të saj çdo situatë shkeljesh ligjore të cilat, edhe nën frymën e neneve D, Dh dhe E të Aneksit të Kushtetutës, përfaqësojnë shkelje të ligjit të afta për të shkaktuar vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra në raport me secilin prej kritereve të rivlerësimit. Konkretisht, neni 61, pikat 1 dhe 3 janë shkaqe shkarkimi për kriterin e pasurisë, neni 61, pikat 2 dhe 3 janë shkaqe shkarkimi për kriterin e figurës, dhe neni 61, pika 4 është shkak shkarkimi për kriterin e aftësive profesionale. Në vlerësimin tonë, në çdo situatë faktike që mund të lidhet me secilin prej kritereve dhe që mund të klasifikohet në secilin prej rasteve të mësipërme, subjekti gjendet në kushtet e vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Në rast se shkeljet e ligjit për secilin kriter, por edhe vetëm për njërin prej tyre janë tilla, që klasifikojnë situatën sipas asaj që parashikojnë pikat 1, 2, 3 e 4 të neni 61, subjekti do të gjendet para vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, siç është edhe rasti objekt gjykimi, i cili me të drejtë është klasifikuar sipas parashikimit të neni 61, pika 3 e ligjit.
8. Në vijim të këtij arsyetimi, mendojmë se në çdo situatë faktike e ligjore, për të cilën subjekti nuk klasifikohet në asnjërin prej rasteve të mësipërme të shkarkimit nga detyra, pasi shkeljet e konstatuara të ligjit nuk gëzojnë statusin e një shkeljeje që mund të shkaktojë klasifikimin e saj sipas asnjë prej rasteve të shkarkimit të cituara më lart, organet e rivlerësimit kanë të drejtë të bëjnë një vlerësim tërësor të tri kritereve ose të procedurave të rivlerësimit, për të matur apo indikuar cenimin e besimit të publikut te drejtësia dhe për të konkluduar nëse ky fenomen ka ndodhur në rastin konkret dhe a është ai në një nivel që të prodhojë vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.
Që ky vlerësim i organeve të rivlerësimit të konkludojë për vendosjen e një mase disiplinore, në këndvështrim të këtij arsyetimi, duhet të shtrihet mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe jo vetëm mbi njërin prej tyre.
9. Nëse organet e rivlerësimit do të aplikojnë zbatimin e neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, mbështetur vetëm në një kriter, ndërkohë që dispozita kërkon vlerësim në përgjithësi të tri kritereve ose në tërësi të procedurave, në vlerësimin tonë do të rrezikonin një vlerësim me doza të larta subjektivizmi dhe përtej diskrecionit të organeve që vetë ligji ka lejuar.

10. Në vlerësimin tonë, në secilin rast që aplikohet një masë disiplinore për secilin nga shkaqet e parashikuara në pikat 1, 2, 3 e 4 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, cenimi i besimit të publikut është i përfshirë nga vetë legjislatori në ngritjen e këtyre shkaqeve në nivelin e krijimit të pasojës që lidhet me masën disiplinore të kualifikuar sipas dispozitave më sipër. Cenimi i besimit të publikut mund të qëndrojë si një shkak më vete shkarkimi dhe, në mungesë të shkaqeve të cilat në mënyrë autonome përbëjnë shkaqe për shkarkim, vetëm atëherë kur subjekti i nënshtrohet vlerësimit në të tria kriteret e rivlerësimit.
- Në këto rrethana, çojmë se cenimi i besimit të publikut të drejtësia, në kuptim të kësaj dispozite, duhet të arsyetohet e mbështetet në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve të rivlerësimit apo në vlerësimin tërësor të procedurave të rivlerësimit në raport me sjelljen e subjektit gjatë këtij procesi. Vlerësimi i cenimit të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë, duke analizuar në mënyrë të veçantë vetëm njërin prej kriterëve të rivlerësimit, nuk vjen në frymën e ligjit nr. 84/2016.
11. Për këto arsye, jemi shprehur kundër konsiderimit si të drejtë të këtij qëndrimi të mbajtur nga Komisioni dhe Kolegji në çështjen objekt gjykimi, qëndrim i cili nuk ka afektuar votën tonë për lënien në fuqi të vendimit nr. 111, datë 27.02.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për të gjitha shkaqe e tjera të konstatuara e të shpallura në vendim.

GJYQTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

GJYQTARE

Ina RAMA

nënshkrimi